



Volumi 2, Edicion Special

Dhjetor 2021

# BULETINI KUNDËR TERRORIZMIT

PËR BALLKANIN, RRETH BALLKANIT

## NË KËTË NUMËR: KESHILLA PRAKTIKE

2	Kundërpyetjet, Pjesa I
3	Kundërpyetjet, Pjesa II
4	Argumentet përmblylëse
4	Hetuesi në bankën e dëshmitarit: Ekzaminimi i drejtpërdrejtë
5	Hetuesi në Bankën e Dëshmitarit: Marrja në Pyetje, Pjesa I
6	Hetuesi në Bankën e Dëshmitarit: Marrja në pyetje, Pjesa II
7	Hetuesi në Bankën e Dëshmitarit: Marrja në pyetje, Pjesa III
8	Mediat sociale si mjet hetimor në hetimet penale
9	Aplikimi i teknikave hetimore në hetimet e terrorizmit: Intervistë
10	Teknikat e hetimit të terrorizmit: Kontrollat e regjistrave
11	Teknikat e hetimit të terrorizmit: Survejimi, Pjesa I
13	Teknikat e hetimit të terrorizmit: Survejimi, Pjesa II
15	Teknikat e Hetimit të Terrorizmit: Informatorët, Pjesa I
15	Teknikat e hetimit të terrorizmit: informatorët, Pjesa II
17	Teknikat e hetimit të terrorizmit: operacionet e infiltruara, Pjesa I
18	Teknikat e hetimit të terrorizmit: operacionet e infiltruara, Pjesa II
19	Teknikat e Hetimit të Terrorizmit: Skena e krimin

## Lajme dhe informacione lidhur me terrorizimin për përditësimin dhe komunikimin mes partnerëve në rajon

*Departamenti i Drejtësisë, Zyra e Ndihmës Zbvillimore dhe Trajnimit Prokurorial (OPDAT) në partneritet me Departamentin Amerikan të Shtetit, Byroja e Antiterrorizmit*

Ndërkohë që i afrohem fundit të vitit 2021, dëshirojmë t'ju falënderojmë për punën tuaj të jashtëzakonshme në hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të terrorizmit. Gjatë këtij viti, Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut riadhesuan secila luftëtarë të huaj terroristë dhe anëtarë të familjeve të tyre nga Siria Verilindore. Kosova ka akuzuar të gjashtë luftëtarët e huaj meshkuj që ka riadhesuar, kurse Maqedonia e Veriut ka akuzuar dhe dënua të dy luftëtarët e huaj meshkuj që ka riadhesuar. Përveç kësaj, shumë raste të tjera terrorizmi janë hetuar dhe janë ndjekur penalisht në të gjithë rajonin, disa vendime gjykatë të shkallës së parë janë lënë në fuqi edhe në apel dhe të paktën një sulm është parandaluar nga policia.

Lufta kundër terrorizmit ka një ndikim jashtëzakonisht të madh dhe përfitime afatgjata. Suksesi juaj në aftësinë për të hetuar dhe ndjekur penalisht këto raste, pavarësisht pandemisë, është tepër mbresëlënëse. Shpresojmë të jeni duke shijuar këto pushime plotësisht të merituar për festa dhe për vitin e ri.

Për buletinin tonë të këtij fundviti, ju paraqesim një përmbledhje të këshillave praktike që kemi dhënë në botimet e mëhershme.

Me urimet më të mira,

Tom Saunders  
Këshilltar Ligjor kundër Terrorizmit  
për Ballkanin  
OPDAT/DOJ; Ambasada e SHBA Sarajevë  
[SaundersTN@state.gov](mailto:SaundersTN@state.gov)

Clay Stiffler  
Këshilltar Ligjor kundër Terrorizmit  
për Ballkanin  
OPDAT/DOJ; Ambasada e SHBA, Tiranë  
[StifflerRC@state.gov](mailto:StifflerRC@state.gov)

Jasenka Ferizović, Këshilltare Ligjore  
OPDAT/DOJ; Ambasada e SHBA Sarajevë  
[FerizovicJ@state.gov](mailto:FerizovicJ@state.gov)

Bledar Bashanović, Specialist Ligjor  
OPDAT/DOJ; Ambasada e SHBA, Tiranë  
[BashanovicB@state.gov](mailto:BashanovicB@state.gov)

## **Këshillë praktike:**

### **Kundërpyetjet, Pjesa I**

Kundërpyetjet kanë dy qëllime kryesore: 1) të ofrojnë prova që mbështesin teorinë e dikujt për një çështje të caktuar dhe 2) prova që rrëzojnë teorinë e së njëjtës çështje nga kundërshtari. Në këtë numër, fillojmë të diskutojmë këto aftësi thelbësore të gjykimit duke hedhur dritë në një sërë aspektesh të neglizhuara dhe shpesh të nënvlerësuara të përfitimeve që ka bërja e kundërpyetjeve.

**Pa dëme = pa kundërpyetje: metodë e vjetruar.** Kundërpyetjet janë parë për një kohë të gjatë thjesht si një betejë me dëshmitarin e kundërshtarit që ka zhvleftësuar ose minimizuar dhe rrallë si një mundësi për të dhënë informacione konstruktive për teorinë e çështjes nga pikëpamja e kundërpyetësit. Megjithatë, kundërpyetjet nuk kanë të bëjnë vetëm me kontrollin e dëmit - ato përbëjnë një mundësi të shkëlqyer për të nxjerrë fakte të favorshme nga dëshmitari i kundërshtarit për të vërtetuar teorinë e prokurorit mbi çështjen. Në fakt, "qasja moderne e kundërpyetjeve kërkon që avokati ta shfrytëzojë dëshmitarin e kundërshtarit - të paktën pjesërisht - sikur të ishte dëshmitari i tij." Kështu, qasja konvencionale se n.q.s. dëshmitari nuk i ka bërë asnjë dëm çështjes së kundërpyetësit lidhur me ekzaminimin e drejtpërdrejtë, avokati duhet të zgjedhë që të mos bëjë asnjë pyetje, është tashmë një qasje e vjetruar.

**Faktet e vërtetuara gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit nga pala kundërshtare (cross-examination) mund të jenë fakte më të besueshme sesa ato që nxirren nga dëshmitari i vetë palës që bën pyetje.** Përdorimi i kundërpyetjeve për të nxjerrë informacione që vërtetojnë fakte të rëndësishme për çështjen. Nëse prokurori nxjerr përmes pyetjeve që i drejton dëshmitarit të mbrojtjes fakte që e mbështesin çështjen e tij, këto informacione janë më të besueshme dhe kanë më shumë peshë sesa po të vërtetohen përmes ekzaminimit të drejtpërdrejtë të dëshmitarit të prokurorisë, pikërisht për shkak se me logjikë të thjeshtë, dëshmitari i kundërshtarit nuk do të nxirrte fakte që janë në favor të palës kundërshtare, nëse ato nuk do të ishin të vërteta. Një tjetër vlerë e shtuar e vërtetimit të fakteve përmes kundërpyetjeve dhe jo përmes ekzaminimit të drejtpërdrejtë është se "në momentin që një fakt pranohet nga dëshmitari i kundërshtarit, kundërshtari është më pak në gjendje të argumentojë kundër besimit në atë dëshmi."

**Përdorimi efikas i teknikave të kundërpyetjeve mund t'ju ndihmojë për uljen e ankthit.** Ankthi është padyshim pjesë e eksperiencës së gjykimit dhe është e rëndësishme që prokurorët të jenë të vetëdijshëm "jo vetëm për atë çka ndodh me trupin, por edhe për çfarë ndodh me mendjen e tyre në këtë proces." Ankthi ngadalëson përpunimin e informacionit, ndikon në procesin e të menduarit dhe ul vetëbesimin, të cilat janë pasoja që prokurorët nuk mund t'ia lejojnë vetes në gjykim, sidomos gjatë kundërpyetjeve, kur secili duhet të fokusohet plotësisht në punën komplekse të formulimit të pyetjeve, peshimit të përgjigjeve, vlerësimit të fjalëve të zgjedhura nga dëshmitari, hezitimeve dhe gjendjeve shpirtërore të dëshmitarit, duke iu përgjigjur në të njëjtën kohë të gjitha kundërshtimeve, duke vëzhguar me kujdes gjyqtarët dhe duke kërkuar provën apo evidencën e duhur. Përvetësimi dhe përdorimi i teknikave të kundërpyetjeve për uljen e ankthit.

**Përdorimi efikas i teknikave të kundërpyetjeve mund t'ju ndihmojë për kontrollimin e dëshmitarëve manipulues.** Ankthi ka të njëjtat efekte edhe ndaj dëshmitarëve. Pse është kjo e rëndësishme? Realiteti që dëshmitarët e thirrur nga pala kundërshtare mund të tundohen po njësoj që të fshehin, të deformatojnë apo të mos zbulojnë plotësisht të gjitha faktet në qoftë se këto fakte mund të cenonin mënyrën se si e shohin ata çështjen. Megjithatë, çdo manipulim apo mashtrim nga pala e dëshmitarëve kërkon më shumë përpunim mendor - dëshmitari duhet të marrë parasysh përgjigjet e dhëna më herët, faktet që ai mund të ketë dhënë para gjykimit, qofshin këto përmes intervistave apo dokumenteve, atë çka beson se do të thonë dëshmitarët e tjerë, çfarë pyetjesh të tjera do bëhen dhe si mund t'i ndryshojë përgjigjet e dhëna më parë çfarëdolloj përgjigje manipuluese që ai mund të japë. Duke qenë se ankthi e ngadalëson përpunimin e informacionit, "teknikat e kundërpyetjeve që sjellin nga ana etike një lloj ankthi në dëshmitarin e kundërshtarit ndikojnë tek aftësia e këtij të fundit për t'u angazhuar në një lloj përpunimi të avancuar që duhet të ketë personi që tenton të shmangë thënien e të vërtetës, të gjithë të vërtetës dhe asgjë përveçse të vërtetës."

Në numrin e ardhshëm, do të flasim për mënyrën e marrjes dhe të ruajtjes së kontrollit ndaj dëshmitarëve dhe për objektin e kundërpyetjeve përmes rregullit "vetëm tre" të kundërpyetjeve.

**Burimi:** L. Pozner dhe R.J.Dodd, *Aftësitë në kundërpyetje për studentët e drejtësisë* (2009)

## Këshillë praktike:

### Kundërpyetjet, Pjesa II

Në këtë numër, ju paraqesim "tre rregullat e marrjes në pyetje të dëshmitarëve nga pala kundërshtare." Këto rregulla janë blloqe të të ndërtuarit të mënyrës së marrjes në pyetje të dëshmitarëve nga pala kundërshtare dhe janë hartuar me qëllim 1) maksimizimin e sasisë së fakteve të dobishme që dalin para gjykatësve dhe që bëjnë të kuptohet menjëherë ndikimi i tyre tek teoria e kundërshtarit për çështjen dhe që 2) ju ndihmojnë të merrni e ta mbani nën kontroll dëshmitarin gjatë marrjes në pyetje. Tre rregullat e vetme të marrjes në pyetje të dëshmitarëve nga pala kundërshtare janë:

**(1) Bëj vetëm pyetje që të çojnë drejt një qëllimi të caktuar.** Mundësia për të bërë pyetje që e drejtojnë procesin drejt një drejtimi të caktuar përbën një aset themelor dallues të së drejtës për kundërpyetje dhe një avantazh të rëndësishëm që ka pala kundërshtare që merr në pyetje dëshmitarin. Ndryshe nga pyetjet e hapura që e shndërrojnë dëshmitarin në mësues të fakteve, pyetjet me një drejtim të caktuar e vënë palën që e merr dëshmitarin në pyetje në pozicionin e atij që i shpjegon faktet, duke i dhënë atij një mundësi të çmuar 1) për të përcaktuar një fushë diskutimi, 2) për të kontrolluar rrjedhën e informacionit, 3) për të kontrolluar faktet që duhet të theksohen dhe emocionin e përgjigjes dhe 4) u shpjegojnë palëve me efikasitet rrethanat e çështjes. Megjithatë, shumë avokatë i lënë t'u ikin nga duart këto avantazhe të mëdha dhe në vend që ta shfrytëzojnë, vazhdojnë me zakonet e bërjes së pyetjeve kryesisht të hapura. Mos e bëni këtë!

Teknika e bërjes së vetëm "pyetjeve që synojnë një drejtim të caktuar" nënkupton që pala që merr në pyetje dëshmitarin të vazhdojë të formulojë vazhdimisht pyetje që synojnë një drejtim të caktuar. Pyetjet që janë vërtet të tilla, pra që çojnë drejt një drejtimi të caktuar, nuk bëjnë vetëm sugjerimin e një përgjigjeje, ato përbëjnë në fakt një deklaratë. Mos përdorni kurrë pyetje që fillojnë me "kush", "çfarë," kur, "ku", "si", "pse", "ose" shpjego", sepse "këto fjalë ftojnë çojnë në përgjigje të pakontrolluara, të paparashikueshme dhe ndoshta edhe të pafundme." Gjithmonë kini parasysh se ai që bën pyetjet nuk duhet të jetë i interesuar në paraqitjen e të gjitha aspekteve të historisë apo që ta bëjë dëshmitarin të shpjegojë gjithçka që dëshiron të shpjegojë dëshmitari – qëllimi juaj i vetëm duhet të jetë që të nxirrni apo të zgjeroni rrethanat që e mbështesin sa më mirë teorinë tuaj të çështjes apo që dëmtojnë sa më shumë teorinë e kundërshtarit.

**(2) Pyesni vetëm për një fakt të ri për pyetje.** Të bërit e pyetjeve për të nxjerrë vetëm një fakt të ri për pyetje e shton një tjetër masë kontrolli. Vendosija e një fakti të ri të vetëm përpara një dëshmitari e ngushton fushën e shmangies, duke e përcaktuar faktin që duhet të diskutohet dhe duke e reduktuar mundësinë e dëshmitarit për t'iu shmangur. Bërija e pyetjeve që përmbajnë më shumë sesa një fakt të ri krijon probleme pavarësisht nga përgjigja. Për shembull, në qoftë se një ekzaminues bën një pyetje kryesore që duhet të përkojë me disa fakte të reja njëherësh dhe dëshmitari përgjigjet "po" ose "jo", do të jetë e paqartë se çfarë me cilin fakt ka të bëjë konfirmimi apo mohimi. Përveç kësaj, një çështje që përmban vetëm një fakt të ri e rrit aftësinë e zbuluesit të faktit për të kuptuar përgjigjen dhe për të kuptuar rëndësinë e faktit të sapovërtetuar: "Struktura e një fakti për pyetje e ndërton me kujdes tablonë në mënyrë që gjykata të arrijë përfundimin e dëshiruar të kundër-ekzaminuesit, edhe pse vetë përfundimi mund të mos dalë kurrë nga dëshmitari." Duke i vërtetuar faktet një nga një dhe duke lënë që çdo fakt të ketë momentin e vet të zbulimit, kundër-ekzaminuesi i shton edhe më shumë ndikim përgjigjes, sepse gjyqtarët përqendrohen në zhvillimin e tablosë shumë kohë përpara se të dalë e gjithë tabloja. Dhe e fundit, kjo teknikë lejon shtimin e një shtrese emocionale ndaj fakteve të posaçme që e sinjalizojnë marrësin në pyetje për rëndësinë e këtyre fakteve të veçanta.

**(3) Ndajeni marrjen në pyetje të dëshmitarit në një seri progresionesh logjike për secilin qëllim specifik.** Duke përdorur rregullin e tre pyetjeve, marrësi në pyetje e kontrollon rrjedhën e pyetjeve, suke i lidhur pyetjet individuale me qëllimet e parazgjedhura dhe të kuptueshme. Zhvillimi i çdo marrjeje në pyetjeje duke u fokusuar tek qëllimet e posaçme faktike ua bën më të lehtë gjyqtarëve linjën e pyetjeve dhe u lejon atyre të dinë se ku po dilni me pyetjet dhe nëse duhet të pranojnë apo jo kundërshtimet e ngritura ndërkohë nga pala tjetër. Gjithashtu, një paraqitje e organizuar dhe e ndarë në disa pika individuale fiton vëmendje dhe siguron që gjyqtarët të kuptojnë se çfarë duhet të marrin nga përgjigja - se ku doni të dilni.

Është e dobishme ta mendoni për këtë teknikë si "mbledhje e një grupi faktesh me qëllim pikturimin e një tabloje të veçantë." Për ta bërë këtë, duhet pikësesari që pyetjet të ndahen sipas qëllimeve të ndara dhe të përcaktuara qartë. Çdo qëllim individual zhvillohet nëpërmjet një përparimi logjik të pyetjeve kryesore, secila duke vënë në pah një fakt të ri. Pyetjet duhet të vazhdojnë nga shumë të përgjithshme deri tek ato që kanë një qëllim specifik. Kjo është e rëndësishme për disa arsye. Së pari, dëshmitarëve zakonisht u duket më e lehtë të bien dakord me pyetjet e përgjithshme përpara se të dalin në hollësi. Së dyti, procedimi me faktet një e nga një ua bën ta pashmangshme përgjigjen - "ndërkohë që dëshmitari pranon një fakt të veçantë, nuk mund të nxirren automatikisht fakte të tjera që ai nuk i ka pranuar ende." Së treti, metoda "nga pyetjet e përgjithshme tek ato specifike" ngjall interes.



## Këshillë praktike:

### Argumentet përmbyllëse

**Fillojeni dhe mbylleni argumentin me një arsytim të fortë.** Informacioni i paraqitur në fillim dhe në fund të argumentit tuaj ka tendencë të mbahet më shumë mend sesa informacioni i paraqitur në mes të tij. Kështu që, sigurohuni që ta filloni me një prezantim të fortë dhe ta mbyllni bindshëm.

**Bëni një ripërmbledhje të provave.** Një argument i mirë përmblyës bën një ripërmbledhje të provave të paraqitura në gjyq. Edhe pse gjykata i ka dëgjuar të gjitha provat, është e rëndësishme që provat të sintetizohen (jo vetëm të përmbledhen) në argumentimin përmblyës. Shpjegoni çdo element të kimit të pretenduar dhe se si e keni vërtetuar atë në terma të thjeshtë dhe të lehtë për t'u kuptuar. Për ta bërë këtë, merrni dëshmitë, dokumentet dhe prova të tjera dhe ndërthurini ato në një histori koherente, logjike dhe të kuptueshme. Sigurohuni që t'i kujtoni gjykatës se çfarë ishte ajo që i bëri të besueshëm dëshmitarët e rëndësishëm dhe të favorshëm. Dëshmia e dëshmitarëve më pak të besueshëm duhet të shprehet në formë përmbledhëse, pa i referuar besueshmërisë së dëshmitarëve.

**Përsëritni informacionet kyçe.** Nuk mund të theksohet sa duhet rëndësia e përsëritjes gjatë gjykimit. Përsëritja e informacioneve është një mjet efektiv për përqëndrimin e vëmendjes së gjyqtarëve në faktet që ju dëshironi të theksoni. Megjithatë, përsëritja dhe ripërsëritja në mënyrë të pavetëdijshme e të njëjtave informacione mund të jetë joproduktive. Për të maksimizuar efektshmërinë e përsëritjes, ndiqni këto tre rregulla të thjeshta: Së pari, çdo përsëritje modifikojeni. Informacionet e përsëritura duhet të jenë të ndryshme nga versioni i parë. Së dyti, përsëritja duhet të përmirësohet. Filloni me përsëritjen tuaj më të dobët dhe bëjeni çdo përsëritje të radhës më të fortë. E treta, bëjini interesante.

**Adresoni çështjen kryesore.** Çështje kryesore është çdo element që kundërshtohet fort dhe që kërkon diskutim të

posaçëm. Në shumë raste, mbrojtja kundërshton vetëm një apo dy çështje. Theksoni se ku bini dhe ku nuk bini dakord me mbrojtjen dhe drejtojini energjitë drejt bindjes së gjykatës për pozicionin tuaj.

**Adresojini dobësitë tuaja.** Mos bëni gabim të mendoni se mund t'i shpërfillni provat e vështira dhe të shpresoni se gjykata nuk do ta vërë re. Sigurohuni që t'i adresoni dobësitë para se të bëjë kundërshtari juaj dhe bëni çmos që t'i neutralizoni faktet kundër çështjes në argumentin tuaj përmblyës.

**Paraprijini dhe sulmoheni qëndrimin e mbrojtjes.** Megjithëse qëllimi juaj kryesor është të bindni gjykatën për mënyrën se si e shihni ju çështjen, në momentin që keni vënë në dukje avantazhet e qëndrimit tuaj, atakoni qëndrimin e palës kundërshtare dhe detyrojeni të argumentojë dobësitë e saj.

**Mos e lexoni argumentin e mbylljes me letër përpara.** Nëse e lexoni apo jo argumentin përmblyës ka të bëjë me mënyrën se si angazhohesh me audiencën, bën dallimin. Nëse lexoni, e keni të pamundur të vendosni kontakt me sy me gjyqtarët. Mbatja e kontaktit me sy është e rëndësishme, pasi i mban gjyqtarët të interesuar dhe të përfshirë dhe duhet të siguroheni që gjatë kohës që flisni, t'i hedhni sytë edhe nga juria, veçanërisht kur nënvizoni pikat më të rëndësishme. Pra, në vend që t'i lexoni argumentet tuaja përmblyëse, përgatisni një përmbledhje me pika. Për të minimizuar kohën që kaloni duke parë shënimet, sigurohuni që të jenë të lehta për t'u lexuar.

#### Burimet:

[Eliot Uilkoks, Rregullat e Përsëritjes](#)

[T. Uollthall, Nga afër: Udhëzues hap pas hapi për dorëzimin e një fjalimi përmblyës të përsosur](#)

[CAIS at Leëis and Clark, Udhërrëfyese për Argumentimin Përmblyës](#)

## Këshilla praktike:

### Hetuesi në bankën e dëshmitarit: Ekzaminimi i drejtpërdrejtë

Ndjekja e suksesshme penale e një çështjeje varet padyshim nga aftësia e prokurorit, por prokurorët nuk mund t'i fitojnë çështjet të vetëm. Roli themelor i prokurorit është që të orkestrojë paraqitjen e provave dhe është pikërisht cilësia e provave nga të cilat varet nëse e fitojnë apo e humbasin një çështje. Cilësia e provave varet së pari dhe mbi të gjitha nga hetimi i policisë dhe nga mënyra se si ato paraqiten gjatë ekzaminimit të tyre të drejtpërdrejtë. Puna e oficerit të policisë nuk mbaron me përfundimin e hetimit. Si dëshmitar kyç në gjykatë, oficeri i policisë vazhdon të luajë një rol vendimtar edhe pasi çështja të ketë mbërritur në sallën e

gjyqit: "Nëse hetuesi nuk e ngre çështjen si duhet nga banka e dëshmitarit, prokurorit nuk i mbetet shumë hapësirë për ta vërtetuar fajin e të pandehurit." Rruga kryesore që ndjek prokuroria për paraqitjen e provave kundër të akuzuarit para gjykatës është ekzaminimi i drejtpërdrejtë. Përmes ekzaminimit të drejtpërdrejtë, prokuroria arrin të nxjerrë dëshmi që ofrojnë apo mbështesin provat e drejtpërdrejta ose rrethanore. Në këtë numër të buletinit, ju ofrojmë disa këshilla praktike për një paraqitje profesionale të dëshmisë së hetuesit dhe të provave gjatë ekzaminimit.

**Paraqitja profesionale.** Paraqitja e dëshmimeve përbën një çështje serioze, kështu që vishuni në mënyrë të përshtatshme. Është e rëndësishme që hetuesi të vishet në mënyrë të përshtatshme dhe konservatore për të pasur një pamje sa më profesionale. Mos mbani asnjëherë armë në sallën e gjyqit dhe kujdesuni që të mos vishni asgjë që mund të duket më autoritare se duhet.

**Mënyra e të folurit.** Kur i drejtoheni gjykatës, flisni qartë, në mënyrë të artikuluar dhe me zë të lartë. Mbani kontaktin me sy me trupën gjyquese. Mendoni para se të përgjigjeni. Flisni ngadalë dhe mos u nxitoni në dhënien e dëshmimeve. Jepuni gjyqtarëve mundësinë që ta kuptojnë dëshminë tuaj.

**Qëndrimi dhe qasja.** Oficeri që jep dëshminë ndihmon për të vendosur kredibilitetin e tij përmes qëndrimit që merr në bankën e dëshmitarit dhe mënyrës se si e paraqet dëshminë. Kështu që, jini të sjellshëm gjatë gjithë kohës. Ruani qetësinë dhe profesionalizmin edhe kur e ndjeni se personi që po ju drejtohet është i padrejtë ndaj jush. Tregoni vetëbesim, por jo arrogancë. Mos krijoni përshtypjen se po tregoheni të padrejtë apo të njëanshëm - nëse ka fakte që e favorizojnë të pandehurin, nxirrini pa hezitim, sepse kjo thjesht ju bën më të besueshëm. Mos i ndërprisni gjyqtarët, prokurorin apo avokatin kur flasin. Nëse një prej tyre ju ndërpret ndërkohë që jeni duke dhënë dëshminë, ndaloni së foluri dhe prisni derisa të zgjidhet çështja që ka shkaktuar ndërprerjen. Ndalojeni dëshminë, kur bëhet një kundërshtim dhe prisni se çdo të thotë gjykata para se të vazhdoni me dëshminë tuaj.

**Përgatitja.** Mos harroni se "performanca në sallën e gjyqit është po aq e mirë sa edhe përgatitja", kështu që bëni më të mirën për t'u përgatitur në mënyrë të detajuar për dëshminë që do të jepni. Për t'u përgatitur si duhet për gjykatën, mbliidhni të gjitha materialet ekzistuese që përmbajnë informacione për çështjen dhe merrni masa që të familjarizoheni me gjithçka që ato përmbajnë. Përveç kësaj, takohuni me prokurorin para gjyqit për të mësuar mbi teorinë e mënyrës se si do të prezantohet çështja nga prokuroria, se si planifikon prokurori ta bëjë këtë paraqitje dhe se çfarë pjese luani ju në këtë prezantim. Është gjithashtu e rëndësishme që të familjarizoheni me teorinë e mbrojtjes për të kuptuar se në cilat pika mund t'ju kapë avokati mbrojtës kur t'ju drejtojë pyetjet dhe çfarë pikash do të përpiqet ai të vërë në pah në dëshminë tuaj. Diskutojini faktet dhe provat

me prokurorin për t'u siguruar se që të dy i kuptoni faktet njësoj dhe për të sqaruar çfarëdolloj konfuzioni para se të zhvillohet gjyqi.

**Mënyra se si duhet t'i përgjigjeni pyetjeve gjatë ekzaminimit të drejtpërdrejtë** Dëgjojini me kujdes pyetjet - sado të thjeshta që mund të duken, është e rëndësishme që të përqendroheni tek të dëgjuarit e pyetjes dhe të mos përgjigjeni asnjëherë pa i dëgjuar ato. Bëni pak pushim para se të përgjigjeni - para se t'i përgjigjeni çfarëdolloj pyetjeje, merrni një moment pushim, në mënyrë që të qartësoni fillimisht mendimet para se të përgjigjeni. Përgjigjuni me ritmin tuaj - merrni gjithë kohën që ju duhet për të dhënë një përgjigje të plotë për pyetjen, por mos e zvarrisni përgjigjen në mënyrë të panevojshme. Përgjigjuni vetëm pyetjes që ju bëhet dhe mos jepni informacione që nuk ju kërkohen - nëse prokurori dëshiron ta shtjellojë përgjigjen, ai jua kërkon vetë këtë. Përdorni gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme - kur nevojitet gjuhë teknike, shpjegojini termat teknike të përdorur. Korrigjoni çdo gabim në dëshminë tuaj sapo ta kuptoni se keni bërë gabim.

**Është e rëndësishme ta dini se kur nuk duhet të përgjigjeni.** Mos iu përgjigjini asnjëherë një pyetjeje që nuk e kuptoni - thoni se nuk e kuptoni pyetjen dhe kërkoni që t'jua përsërisin me fjalë të tjera. Gjithashtu, mos u përgjigjini duke hamendësuar - nëse nuk e dini përgjigjen, thuajeni hapur se nuk e dini. Ose, nëse nuk jeni i sigurt se si të përgjigjeni, thjesht thoni se nuk jeni i sigurt.

**Burimi:** D. Lewis, *oficeri i policisë në sallën e gjyqit: Si të shmanjim grackat e ekzaminimit të dyfishtë përmes përgatitjes së duhur dhe paraqitjes së duhur të raporteve të hetimit, dëshmia në gjykatë dhe provat* (2001)

## Këshilla praktike

### Hetuesi në Bankën e Dëshmitarit: Marrja në Pyetje, Pjesa I

Bërja e pyetjeve është mjeti kryesor dhe shpesh i vetmi mjet që kanë avokatët mbrojtës për të eksploruar dëshmitë e dëshmitarëve të prokurorisë dhe për të nxjerrë informacione që do të ishin në dëm të prokurorisë ose të dobishme për të pandehurin. Avokatët mbrojtës bëjnë çmos për ta përdorur këtë mundësi për të diskredituar dëshminë e hetuesit, duke bërë që hetimi i tij të duket i paplotë ose jo kompetent, por edhe duke bërë që hetuesi të duket jo efikas, i paaftë ose i pabesueshëm. Në këtë numër të buletinit ju paraqesim disa nga taktikat e përgjithshme që avokatët mbrojtës përdorin për të sulmuar hetuesit gjatë marrjes në pyetje, si dhe disa këshilla se si t'u përgjigjeni sa më mirë. Do të vazhdojmë ta eksplorojmë këtë temë edhe në numrin e ardhshëm.

**1. Intimidimi.** Avokatët mbrojtës përdorin strategji të ndryshme në përpjekje për të intimiduar dëshmitarët. Ndryshimi i tonit të tyre të zërit dhe përdorimi i pyetjeve të shpejta janë vetëm dy nga këto strategji:

**Toni i zërit.** Avokati mbrojtës e ndryshon tonin e zërit gjatë rrjedhës së pyetjeve për të ndikuar në qetësinë përgjigjen e hetuesit. Ai përdor një ton të mërzitshëm zëri për t'i lënë gjykatës të kuptojë se dëshmia e hetuesit është e pavërtetë ose e parëndësishme. Nëse flet me ton të butë ose kureshtar, ai mund të përpiqet t'i përçojë hetuesit një ndjenjë të rremë sigurie, që atij t'i shpëtojë diçka pa e kuptuar. Zakonisht, avokatët mbrojtës flasin me ton të lartë dhe kërcënuen kur dëshmia e hetuesit ua dëmton rëndë çështjen dhe kur duan që hetuesi të bëhet mbrojtës dhe luftarak. Megjithatë, avokati nuk mund ta ngrëjë si duhet tonin dhe të vazhdojë po ashtu, pa bashkëpunimin e hetuesit. Pra, kujdesuni që ta dëgjoni me kujdes atë që kërkohet, mënyrën si bëhen pyetjet dhe përgjigjuni në mënyrë të qetë, profesionale — në këtë mënyrë, do të jetë avokati ai që do të panikohet, jo ju.

**Ritmi i pyetjeve.** Avokati mbrojtës mund të pyesë me një ritëm të shpejtë për ta ngatërruar hetuesin, duke mos i dhënë atij mundësi për të menduar dhe për t'u përgjigjur me ritmin e tij. Mos lejoni që t'ju imponohet ritmi i avokatit. Merrni të gjithë kohën që ju nevojitet për ta kuptuar si duhet pyetje dhe për të dhënë një përgjigje të plotë.

**2. Bërja e pyetjeve të shumta ose të komplikuar.** Avokati mbrojtës ndonjëherë bën pyetje komplekse ose të komplikuar për ta ngatërruar hetuesin. Kur avokati bën një pyetje të shumëfishtë (d.m.th. një deklaratë të vetme që përmban në fakt dy ose më shumë pyetje), ju mund ta theksoni se ai në fakt ka bërë dy pyetje dhe pastaj t'u përgjigjet të dyja pyetjeve, njëra pas tjetrës, me kusht që ato të jenë pyetje të thjeshta. Megjithatë, nëse pyetjet janë komplekse ose kërkojnë përgjigje të gjata, thjesht pyeteni avokatin se cilës pyetje do të donte që t'i përgjigjeni në fillim dhe mos iu përgjigjeni të dyjave menjëherë.

**3. Pyetje tendencioze.** Avokati mbrojtës bën pothuajse gjithmonë pyetje tendencioze kur merr në pyetje dëshmitarin e akuzës. Pyetje tendencioze janë ato pyetje që kërkojnë përgjigjen "po" ose "jo", duke mos e lënë kështu hetuesin ta zgjerojë përgjigjen në dëm të mbrojtjes. Nëse mendoni se po ju bëhet një pyetje, së cilës nuk mund t'i përgjigjeni dot thjesht me "po" ose me "jo", pasi një përgjigje e tillë do të ishte çorientuese, duhet së pari t'i përgjigjeni pyetjes dhe pastaj të ofroni shpjegimin. Nëse avokati mbrojtës ju ndërpret para se ta përfundoni përgjigjen, dhe të paktën ta keni sinjalizuar prokurorin për t'iu kthyer të njëjtës fushë për shpjegime të mëtejshme për t'i dhënë një tjetër drejtim bërjes së pyetjeve.



**4. Pyetje që përmbajnë gjysmë të vërteta.** Avokati mbrojtës mund të bëjë pyetje që përmbajnë informacione që janë vetëm gjysmë të vërteta. Kujdes nga pyetje të tilla. Ato mund të duken të besueshme dhe t'ju provokojnë të jepni një përgjigje të thjeshta "po" ose "jo", edhe kur kjo nuk është 100% e pasaktë. Pra, nëse një pyetje nuk është plotësisht e saktë, thuajeni këtë dhe jepni çfarëdolloj shpjegimi të nevojshëm.

**5. Dhënia e një sensi të rreme sigurie hetuesit.** Një taktikë tjetër e përdorur zakonisht nga avokatët mbrojtës është që hetuesi të ndihet i relaksuar dhe i sigurt në vetvete. Kur hetuesi e ul vigjilencën, ai mund të bëhet lehtësisht i pakujdesshëm në përgjigje dhe ka më shumë gjasa të bjerë në kurthe të ngritura nga avokati mbrojtës. Ka disa qasje që avokati mbrojtës mund t'i përdorë për t'i dhënë hetuesit një ndjesi të rremë sigurie:

**Bërja "sikur nuk di".** Avokati mbrojtës mund të bëjë pyetje që të lënë përshtypjen se ai nuk ka njohuri për thelbin ose se nuk ka shumë ekspertizë në fushën e dëshmisë. Kjo është një hile që synon ta bëjë hetuesin të ndihet i sigurt, kështu që avokati të mund ta sulmojë pasi ai ta ketë humbur dhe të ketë filluar të ndihet i qetë.

**Paraqitja si i drejtë dhe i sjellshëm.** Kur avokati mbrojtës përpiqet të jetë jashtëzakonisht i drejtë dhe i sjellshëm, ai mund të përpiqet të bëjë hetuesin të besojë se nuk do të ketë sulme apo konfrontime. Sapo hetuesi ta ketë humbur vigjilencën, ai ka më shumë gjasa të bëjë gabime serioze. Kujdes nga këto taktika dhe mos e humbisni vigjilencën!

**Burimi:** D. Lewis, *oficeri i policisë në sallën e gjyqit: Si të shmangim grackat e ekzaminimit të dyfishtë përmes përgatitjes së dubur dhe paraqitjes së dubur të raporteve të hetimit, dëshmia në gjykatë dhe provat* (2001)

## Këshilla praktike

### Hetuesi në Bankën e Dëshmitarit: Marrja në pyetje, Pjesa II

Në këtë numër, vazhdojmë të eksplorojmë taktikat që përdorin zakonisht avokatët për të sulmuar hetuesin marrjes në pyetje dhe strategjitë më të mira të reagimit ndaj tyre.

**1. Deklarata të gabuara lidhur me dëshminë e mëparshme.** Shpesh, avokati mbrojtës e kalon dëshminë e drejtpërdrejtë të hetuesit bashkë me të, dhe, duke ritheksuar një pjesë të dëshmisë së dhënë më parë, përpiqet që t'i ndryshojë me elegancë ca gjëra, që në të vërtetë ndryshojnë të gjithë kuptimin e deklaratës. Ai më pas i kërkon hetuesit të konfirmojë deklaratën e modifikuar si dëshmi e tij për ekzaminim të drejtpërdrejtë. Për ta shmangur këtë, dëgjojini me kujdes pyetjet para se t'u përgjigjeni dhe, pavarësisht se sa i pafajshëm mund të duket gabimi, nëse avokati bën gabime kur riphon ndëshminë tuaj, thuajeni. Avokati pastaj mund të



përpiqet të perifrazojë versionin e tij dhe t'ju kërkojë përsëri ta konfirmoni. Megjithatë, mos e konfirmoni nëse nuk është ajo që ju dëshmuat.

**2. Personalizimi i të pandehurit.** Avokati do të shfrytëzojë çdo mundësi për ta përshkruar të pandehurin si njeri të mirë pavarësisht provave për fajësinë e tij nga kush më mirë se nga hetuesit do të donte të dëgjonte ndonjë fjalë të mirë. Për ta arritur këtë, avokati mund t'i drejtohet të pandehurit në emër, duke shpresuar që edhe ju të bëni të njëjtën gjë; ose mund t'i drejtohet të pandehurit me terma afeksionues ose të thotë gjëra rreth tij që e bëjnë atë të duket mirë dhe pastaj të kërkojë konfirmim nga ju për deklaratat e tij për të pandehurin. Jini të vetëdijshëm për këtë taktikë dhe mos lejoni që të bëheni dëshmitar i karakterit të të pandehurit. “

**3. Kontradiktat në dëshminë e hetuesit.** Çdo herë që një person e tregon një histori më shumë se një herë, do të ketë mospërputhje, pavarësisht sa me kujdes tregohet historia. Hetuesi mund të presë që avokati të theksojë kontradiktat në dëshminë e tij për t'i dëmtuar kredibilitetin. Kur tregoni ngjarje të kaluara, përdorni ato që kujtoni më mirë dhe kur përbaleni me një mospërputhje, shpjegojeni nëse mundeni. Nëse nuk mundeni, thjesht tregojini avokatit se dëshmia juaj e tanishme është ajo cka mbani mend më mirë. Nëse, kur ju vënë përballë deklaratave tuaja të mëparshme që nuk janë në përputhje me dëshminë tuaj të tanishme, ju freskohet kujtesa dhe e ndjeni se ajo cka thatë më parë ishte e saktë, pranohet gabimin dhe konfirmoni deklaratën e mëparshme.

**4. Pyetje jashtë fushës së hetuesit .** Gjatë pyetjeve, hetuesit mund t'i bëhen ndonjëherë pyetje që janë të lidhura me policinë dhe që dalin jashtë fushës së tij të ekspertizës ose njohurive të tij. Shpesh avokatët e mbrojtjes i bëjnë këto pyetje me qëllim që oficerët e policisë që japin dëshmi të pranojnë mungesën e njohurive ose ekspertizës për një çështje të caktuar ose t'i bëjnë ata të përpiqen t'u përgjigjen pyetjeve për të cilat nuk janë të kualifikuar për t'u përgjigjur, duke shpresuar se në secilin rast përgjigjja e tyre do t'i bëjë të duken të paaftë. Mos bini në këtë kurth. Nëse ju bëhen pyetje të tilla, thoni pa hezitim se kjo fushë specifike e zbatimit të ligjit nuk është brenda fushës suaj të ekspertizës ose që nuk keni marrë pjesë në atë fazë të veçantë të hetimit. Mos kërkonit falje dhe mos u justifikoni për mungesën e njohurive ose të ekspertizës.

## Këshilla praktike

### Hetuesi në Bankën e Dëshmitarit: Marrja në pyetje, Pjesa III - 3

Në këtë numër të buletinit plotësojmë serinë e këshillave praktike për ekzaminimin e tërthortë me disa këshilla të përgjithshme mbi “ato cka duhen bërë dhe ato cka nuk duhen bërë ” nga hetuesi në bankën e dëshmitarit.

**1.** Dëgjoni me kujdes çdo pyetje. Nëse nuk e dëgjoni dot pyetjen, kërkojini avokatit mbrojtës ta përsërisë. Nëse nuk e kuptoni pyetjen, kërkonit sqarime. Dhe nëse nuk dini t'i përgjigjeni, thoni se nuk dini t'i përgjigjeni.

**5. Bërja e një blloku pyetjesh.** Avokati i mbrojtjes mund ta ndajë ekzaminimin në segmente, ku secili segment ka qëllimin e vet: “Pyetjet në secilin segment do të drejtohen drejt atij qëllimi dhe secili ka për qëllim të japë një përgjigje që ndjek një sekuençë që avokati shpreson se do të mbarojnë sipas pritshmërisë së tij”. Duke bërë këtë, avokati i mbrojtjes kombinon disa nga taktikat e tjera që kemi adresuar tashmë: Për të ndërtuar dëshminë e hetuesit në një mënyrë që i përshtatet më mirë rastit të mbrojtjes, avokati zakonisht fillon me pyetjet më të pafajshme. Këto pyetje drejtohen në mënyrën më delikate dhe të paqëllimshme të mundshme. Avokati i mbrojtjes fillon dhe e drejton vëmendjen e hetuesit në faktet për të cilat ai dëshiron që oficeri të dëshmojë dhe përpiqet të “kundërshtojë” përgjigjet e para, duke i përzier këto pyetje me pyetje të tjera të pafajshme për të lënë përshtypjen se ai nuk është duke kërkuar për ndonjë gjë të dëmshme për ndjekjen penale. Nëse hetuesi bie në këtë kurth, ai do të përfundojë në një situatë ku çdo përgjigje që jep forcon atë të mëparshmen derisa të vihet në një pozicion ku çdo herë që përpiket të ndryshojë pozicionin e tij, ai konstaton se është e pamundur sepse është aq thellësisht i lidhur me përgjigjen e tij të mëparshme.

**6. Pyetje të gjera dhe gjithëpërfshirëse.** Një avokat mbrojtës do të bëjë pyetje të gjera dhe gjithëpërfshirëse për tre arsye: 1) i mungon informacioni rreth fakteve që rrethojnë çështjen e ekzaminimit; 2) është në një ekspeditë peshkimi, duke shpresuar të dëgjojë informacionin se ai nuk ishte i vetëdijshëm derisa të jepet përgjigja dhe 3) dëshiron të marrë angazhimin nga dëshmitari dhe, në të njëjtën kohë, të mashtrojnë dëshmitarin për kuptimin e pyetjes, kështu që më vonë gjatë ekzaminimit, ai mund ta përdorë përgjigjen për atë pyetje për të sulmuar dhënien e një përgjigjeje për një pyetje tjetër. Jini të vetëdijshëm për këto taktika dhe mendojini pyetjet para se t'u përgjigjeni.

**Burimi:** D. Lewis, *oficeri i policisë në sallën e gjyqit: Si të shmangim grackat e ekzaminimit të dyfishtë përmes përgatitjes së duhur dhe paraqitjes së duhur të raporteve të hetimit, dëshmia në gjykatë dhe provat* (2001)

**2.** Përgatituni për gjykim - njihini elementet e krimit për të cilat po dëshmoni dhe parashikoni dhe kuptoni teoritë e ndjekjes penale dhe mbrojtjes së çështjes.

**3.** Gjithmonë jini të sigurt si në sjellje, ashtu edhe në përgjigjet që jepni, por kujdesuni që të mos dukeni arrogant. Jini të sqartë, modest dhe të natyrshëm.

**4.** Jini të sqartë, por kurrë informal në ndërveprimet tuaja me gjykatën, prokurorin ose me avokatin mbrojtës.

**5.** Flisni qartë dhe me zë të lartë.

**6.** Jini konciz dhe të drejtpërdrejtë në përgjigjet tuaja. Mos jepni informacione pa ju pyetur njeri.

**7.** Asnjëherë mos spekuloni, mos hamendësoni dhe mos jepni mendime që nuk jeni të kualifikuar t'i jepni.

8. Para se t'i përgjigjeni çdo pyetjeje, merrni kohë për të organizuar përgjigjen. Mos e lejoni avokatin mbrojtës të ndikojë në ritmin dhe gjatësinë e përgjigjeve tuaja.

9. Jini të drejtë dhe të saktë, por të sigurt kur të paraqisni faktet.

10. Gjithmonë korrigjoni keqpërdorimin nga avokati mbrojtës të çdo fjale apo frazë që i referohet hetimit tuaj dhe cdo keqinterpretim të deklaratave tuaja. Mos lejoni që avokati mbrojtës të vërë fjalët e tij në gojën tuaj, por as mos i hyni argumentimit me avokatin mbrojtës mbi kuptimin apo interpretimin e fakteve apo të dëshmimeve.

11. Qëndroni vigjilent dhe mos lejoni që të bini në një pozitë të rreme sigurie.

12. Kontrollini emocionet dhe mos shfaqni nervozizëm. Mos u trondisni nëse diçka shkon keq.

13. Mos iu drejtoni të pandehurit në emër. Referojuni personit me mbiemër, duke e përdorur atë me korrektesë, ose referojuni thjesht si "i pandehuri".

14. Mos shfaqni armiqësi ndaj të pandehurit apo avokatit mbrojtës.

**Burimi:** D. Lewis, *oficeri i policisë në sallën e gjyqit: Si të shmangim grackat e ekzaminimit të dyfishtë përmes përgatitjes së dubur dhe paraqitjes së dubur të raporteve të hetimit, dëshmia në gjykatë dhe provat* (2001)

## Këshilla praktike

### Mediat sociale si mjet hetimor në hetimet penale

Në këtë numër flasim për vlerën që kanë mediat sociale si prova dhe për rëndësinë e përdorimit të mediave sociale si një mjet hetimor në punën rutinore hetimore.

Mediat sociale kanë një pozicion të rëndësishëm në tërësinë e mjeteve ekzistuese të zbatimit të ligjit në hetimet penale rutinë, veçanërisht të krimeve të motivuara ideologjiksht dhe autorëve të kryejnë akte terrorizmi dhe dhunë ekstremiste. Hetuesit kundër terrorizmit mund të përdorin mediat sociale si në hetime të reaktive ndaj ngjarjeve terroriste, por edhe për të identifikuar në mënyrë proaktive individët që duket se kanë ndër mend të kryejnë akte dhune me shpresën e shkatërrimit të planeve të tyre. Mediat sociale janë në këtë mënyrë edhe një mjet hetimor proaktiv dhe reaktiv që mund të shfrytëzohet nga zbatimi i ligjit nëpërmjet fazave të ndryshme të veprimtarisë kriminale, nga parandalimi i krimit deri te hetimi i krimit.

Mediat sociale mund të përdoren në mënyrë proaktive për të identifikuar sjelljet kriminale, shkelësit e mundshëm dhe për të parandaluar veprat penale. Autorët nganjëherë transmetojnë qëllimet e tyre kriminale në llogaritë e mediave sociale duke postuar kërcënime ose plane potenciale dhe nëse zbatimi i ligjit bëhet i vetëdijshëm për postimet e tilla në kohën e duhur, u ofron atyre mundësinë për të ndërhyrë dhe për të parandaluar një krim para se ai të ndodhë.

Mediat sociale gjithashtu mund të shfrytëzohen si mjet hetimor pasi të ketë ndodhur një ngjarje penale dhe pasi të kenë filluar hetimet nga agjencitë e zbatimit të ligjit. Informacioni i postuar përmes llogarive të mediave sociale mund të përdoret për të verifikuar alibitë, për të demonstruar *mens rea*, për të siguruar dëshmi për veprat e paramenduara, si dhe për lidhjen e autorëve me rrjetet e tyre sociale, identifikimin e një motivi, identifikimin e dëshmitarëve dhe për të verifikuar ose kundërshtuar vërtetësinë e dëshmitarit gjatë një gjykimi. Në hetimet e terrorizmit "llogaritë e mediave sociale të terroristëve mund t'i japin edhe më shumë kontekst krimit të tyre, duke demonstruar interesin, mbështetjen e zjarrtë për ideologjitë, lëvizjet dhe organizatat ekstremiste". Përveç kësaj, ato mund t'i ndihmojnë hetuesit për të kuptuar se si është radikalizuar autori ose me kë ka ndërvepruar në mediat sociale, për të vërtetuar motivin, si dhe për të identifikuar personat e tjerë që mund të kenë ndihmuar në veprën penale ose që mund të angazhohen në akte të tjera në të ardhmen.





Nëpërmjet mediave sociale, organet e zbatimit të ligjit mundet që, me pak përpjekje, të kenë akses në informata relevante. Mediat sociale përdoren më së shpeshti për:

**1. Identifikimin e personave me interes.** Një nga detyrat kryesore të çdo hetuesi është ajo e identifikimit të personave me interes dhe bashkëpunëtorëve të lidhur me ta. Nëpërmjet llogarive të mediave sociale publike, të njohurit e rrjeteve sociale dhe marrëdhëniet mes tyre në ditët e sotme mund të identifikohen dhe të analizohen me klikimin e një butoni, veçanërisht me ndihmën e softuerit ekzistues të specializuar të analizës së rrjeteve sociale. Hetuesit mund të përdorin gjithashtu vende online si dhomat e bisedave për të identifikuar personat me interes nga të cilët mund të mbledhin inteligjencë të dobishme.

**2. Identifikimin e vendndodhjes së aktivitetit kriminal.** Disa shërbime të mediave sociale ofrojnë të dhëna gjeografike dhe kohore për vendndodhjen e një individi gjatë postimit. Përveç kësaj, fotografitë ë ngarkohen në llogari mund të kenë koordinata gjeografike nëse merren me telefona celularë ose kamera digjitale me aftësi gjeotiketimi. Ky lloj informacioni mund të përdoret për të identifikuar vendndodhjen e veprimtarisë kriminale, për të vërtetuar një të dyshuar në një skenë krimi ose për të verifikuar alibinë e individit.

**3. Mbledhjen e fotografive, videove ose deklaratave për të vërtetuar provat.** Përditësimet e statusit, postimet, fotografitë dhe videot e ngarkuara nga përdoruesit mund të jenë gjithashtu pjesë të vlefshme provash. Fotografitë ose videot e postuara në faqet e mediave sociale mund ta vendosin një të dyshuar në një skenë në kohën përkatëse, ta lidhin të dyshuarin me viktimat ose të provojnë ekzistencën e një fakti. Përveç kësaj, postimet në faqet e mediave sociale ndonjëherë mund të përdoren për të provuar mentalitetin e një kriminelit të veçantë.

**4. Identifikimin e aktivitetit kriminal.** Mediat sociale shfrytëzohen në mënyrë rutinore për të identifikuar dhe për të dënuar aktivitetin kriminal ë mund të shfaqen në faqe të tilla si Facebook, Twitter dhe YouTube. Nuk është e pazakontë ë kriminelët të publikojnë fotografi dhe video inkriminuese të veprave penale në faqet e mediave sociale si Facebook dhe YouTube. Edhe pse në shumë raste videot dhe fotografitë mund të ngarkohen me një shkallë anonimiteti, është e rëndësishme të kihet parasysh se video ose imazhi i tillë i publikuar në mënyrë anonime mund të krijojë bazë ligjore për marrjen e një urdhri kontrolli për të kërkuar informacion shtesë në lidhje me llogarinë ku është ngarkuar materiali.

Kështu, prania e dikujt në internet mund të lërë një gjurmë të madhe informacioni të dobishëm prapa, prandaj hetimi i mediave sociale duhet të jetë pjesë e një pune rutinë hetimore të çdo hetuesi të zbatimit të ligjit.

**Burimet:** S.K. Rice dhe W.S. Parkin, *Mediat Sociale dhe Hetimet e Organeve të Zbatimit të Ligjit*, Oxford Udhëzimet Online Analiza Akademike (2016)

J. Brunty dhe K. Helenek, *Hetimi i Mediave Sociale për Llogari të Zbatimit të Ligjit*, Anderson Publishing, (2013)

## Këshilla praktike

### Aplikimi i teknikave hetimore në hetimet e terrorizmit: Intervistë

Edhe pse teknikat hetimore të përdorura në hetimet e terrorizmit janë në thelb të njëjta me ato që hetuesit përdorin në rastet e zakonshme penale, aplikimi i tyre shpesh ndryshon. Terroristët në përgjithësi kanë frikë nga zbatimi i ligjit dhe bëjnë gjithçka që mundën për të mos u kapur. Për të qëndruar jashtë radarëve të zbatimit të ligjit, terroristët, ndryshe nga kriminelët e zakonshëm, i kushtojnë jashtëzakonisht rëndësi sigurisë, duke ua bërë të vështirë hetuesve të policisë monitorimin e aktiviteteve të tyre dhe arrestimin dhe ndjekjen penale. Shumë prej tyre i njohin metodat dhe strategjitë hetimore, të cilat shpesh kufizojnë përdorimin e teknikave të caktuara hetimore në rastet e terrorizmit.

Megjithatë, fakti që shumë terroristë janë të vetëdijshëm për teknikat hetimore të zbatimit të ligjit nuk do të thotë se nuk mund të përdoren këto metoda të përpunimit të informacionit — thjesht do të thotë se gjatë hetimit duhet të tregohet më shumë kujdes: “Gjatë hetimit, vëmendje e madhe duhet t’u kushtohet detajeve. Duhet të shmangen pakujdesitë dhe gabimet. Është i domosdoshëm

dokumentimi i duhur dhe i shpejtë i rezultateve të çdo teknike hetimore. Duhet të ndiqen rregullat dhe procedurat në lidhje me përdorimin e këtyre teknikave. Teknikat hetimore duhet të përdoren me kujdes”.

Në këtë numër, ju ofrojmë disa këshilla se si të shfrytëzoni në mënyrë efektive në hetimet e terrorizmit “shtyllën e të gjitha teknikave hetimore”: intervistën.

**Përgatitja.** Edhe pse ka situata kur hetuesi ka pak ose aspak kohë për t’u përgatitur për intervistën, intervistat që planifikohen që më përpara mund dhe duhet të organizohen dhe të planifikohen me kujdes. Kjo nuk do të thotë vetëm që të mendohen pyetje cilësore për subjektin apo që të njihen aktivitetet e subjektit dhe të grupit të tij: “Në fakt, aspekti më i vlefshëm i përgatitjes është të dihet se kur është koha më e përshtatshme për ta kontaktuar personin, të dihet si të thyhet akulli, si dhe si mund të nisë biseda me të.”

**Zhvillojini intervistat me kujdes dhe në detaje.** Shumë terroristë nuk pranojnë të bashkëpunojnë me forcat e zbatimit të ligjit apo që të intervistohen për asnjë gjë. Kështu që, me ata që bien dakord për një intervistë, hetuesit duhet të jenë të vetëdijshëm se mund të jetë intervista e vetme që do të marrin ndonjëherë për këtë temë. Për këtë arsye, është thelbësore që hetuesit të shqyrtojnë me vëmendje informacionin e marrë nga intervista dhe të bëjnë përpjekjet e nevojshme për të identifikuar provat, dëshmitarët dhe elementët e tjerë që mund të përdoren për të konfirmuar

deklaratat e subjektit, nëse ai më vonë duhet të largohet ose të refuzojë të dëshmojë. Hetuesi që kryen një intervistë duhet gjithmonë të sigurohet që të adresojë dhe të përpiqet të marrë përgjigjet për këto pyetje kryesore: Kush?, Çfarë?, Kur?, Ku?, Pse?, Si?.



**Kuptoni konceptet kryesore të besimeve të subjektit.** Për të kuptuar më mirë mendësinë dhe deklaratat e subjektit, hetuesit duhet të kenë të paktën disa njohuri bazë rreth filozofisë politike ose pikëpamjeve fetare të subjektit që planifikojnë të intervistojnë. Një oficer që i përgjigjet me injorancë të plotë retorikës së subjektit ka të ngjarë të dështojë në përpjekjet e tij për ta intervistuar atë person. Megjithatë, është gjithashtu e këshillueshme që hetuesi të

mos bëjë sikur është “ekspert” i filozofisë politike apo fesë së subjektit. Hetuesi ka më shumë gjasa të ketë sukses në angazhimin e subjektit në diskutim nëse tregon se është i vetëdijshëm për konceptet që janë çelësi i besimeve të subjektit.

**Mos u përfshini në debate politike ose ideologjike me të intervistuarit.** Siç u përmend më sipër, është e rëndësishme që hetuesit të kuptojnë pikëpamjet politike ose fetare të subjektit që planifikojnë të intervistojnë, dhe gjatë intervistës ata nuk duhet të futen në diskutime të aspekteve të caktuara të besimeve të subjektit, sepse deklaratat e bëra nga një i intervistuar në lidhje me besimet e tij mund të përdoren si dëshmi kundër tij në gjykatë. Megjithatë, ky diskutim nuk duhet të kthehet në debat.

**Asnjëherë mos bini dakord dhe as mos mbështesni asnjë veprim të paligjshëm që një terrorist përmend gjatë një interviste.** Megjithëse ndonjëherë është e rëndësishme të tregohet ndjeshmëri ndaj besimeve të personit për të zhvilluar intervistën, është gabim që një hetues të supozojë se mund të fitojë besimin e një subjekti duke pretenduar se mbështet aktivitetet terroriste të kryera nga subjekti dhe grupi i tij. Gjithashtu, deklarata të tilla mund të kthehen më vonë kundër hetuesit nëse ai thirret për të dhënë dëshmi në gjykim.

**Burimi:** William E. Dyson, *Terrorizmi: Udhëzuesi i një hetuesi*, Botimi i tretë, Anderson Publishing (2008)

## Këshilla praktike

### Teknikat e hetimit të terrorizmit : Kontrollet e regjistrave

Një nga burimet më të arritshme dhe shumë të vlefshme në dispozicion të një hetuesi është kontrolli i të dhënave. Kontrolli i të dhënave përfshin të dhënat e qeverisë, si të dhënat penale të një të dyshuari ose të dhënat tatimore. Ato përfshijnë edhe shënimet e mbajtura nga kompani private, siç janë regjistrimet telefonike dhe regjistrat e pronave. Për shkak se kontrollet e të dhënave pothuajse gjithmonë mund të kryhen pa dijeninë e subjektit, ato janë veçanërisht të rëndësishme në hetimet e terrorizmit, kur agjencitë e zbatimit të ligjit duhet të jenë të kujdesshëm për të mos e sinjalizuar subjektin se është nën hetim. Duke vëzhguar të gjitha subjektet që mund të japin informacion mbi temën e një hetimi, një hetues shumë shpesh mund të ndërtojë një profil të gjerë mbi subjektin pa dalë fare nga zyra. Megjithatë, shumë hetues nuk e shfrytëzojnë plotësisht potencialin e kësaj teknike hetimi.

Në këtë numër ju ofrojmë disa këshilla për kryerjen e kontrolleve efektive të të dhënave.

**Kontrolloni të dhënat e agjencisë suaj.** Hapi i parë në çdo hetim duhet të jetë kontrolli i emrave të subjekteve duke kaluar nëpër të gjitha të dhënat e agjencisë apo institucionit të vetë hetuesit. Nëpërmjet të dhënave të agjencisë, hetuesi

do të jetë në gjendje të vërtetojë nëse subjekti është duke u hetuar ndërkohë edhe nga një anëtar tjetër i departamentit të tij ose nga kolegët e tij në departamente të tjera të së njëjtës agjenci, ose nëse subjekti është hetuar në të kaluarën. Njohja e historikut të subjektit me agjencinë mund të kursejë shumë kohë duke e ndihmuar hetuesin që të mos bëjë edhe një herë një punë që e kanë bërë më parë të tjerët. Hetuesi duhet të kontrollojë të dhënat e agjencisë së tij për emrat e të afërmeve të subjektit apo të bashkëpunëtorëve të tij të ngushtë, sepse informacioni në lidhje me këta individë mund të sigurojë jo vetëm inteligjencë në lidhje me subjektin, por edhe informacion në lidhje me informatorët e mundshëm që mund të jenë në gjendje të ndihmojnë në hetim.

**Kontrolloni edhe të dhëna të tjera të agjencive të zbatimit të ligjit** Kontrollet e të dhënave nuk duhet të kufizohen vetëm tek agjencia e vet hetuesit: “Një hetues i mençur kontrollon emrin e një subjekti të ri që sapo i është caktuar të hetojë nëpërmjet agjencive të zbatimit të ligjit ku mendohet të ketë të dhëna brenda zonës së tij gjeografike për të përcaktuar nëse kanë ndonjë informacion mbi subjektin dhe nëse po, çfarë informacioni?”. Në shumicën e rasteve, mund të pyeten këto agjenci të tjera të zbatimit të ligjit pa frikën e prishjes së një hetimi. Kujdes mund të nevojitet nëse subjekti është oficer i zbatimit të ligjit ose nëse zyrtarët e zbatimit të ligjit brenda agjencisë që kontrollohet kanë anëtarë që janë disi të lidhur me veprimtarinë penale që po hetohet. Hetuesit duhet gjithashtu të mos harrojnë të shfrytëzojnë task force-at ekzistuese për të përsheptuar kontrollet e të dhënave, sepse agjencitë anëtare të task force-ave duhet të jenë në gjendje të kontrollojnë të dhënat e

agjencive të tyre në një mënyrë më të shpejtë dhe më të plotë sesa mund të vepronin jashtë agjencive.

**Kontrolloni të dhënat e agjencive/shërbimeve publike/kompanive të tjera.** Çdo agjenci që ka ndikim mbi subjektin duhet të ketë, në një formë apo një tjetër, të dhëna për atë person: “Këto shënime mund të japin një shumëllojshmëri faktesh interesante që mund të jenë me vlerë në një hetim. Shpesh, vetë informacioni nuk ka ndonjë vlerë të madhe, por kur kombinohet me fakte të tjera të gjetura rreth subjekti, mund të bëhet i rëndësishëm”. Disa nga të dhënat e mbajtura nga agjencitë e tjera që mund të rishikohen për informacion mbi subjektin janë të dhëna mbi taksën mbi pronën, licencat profesionale dhe lloje të tjera licencash, lejet e llojeve të ndryshme, patentat e shoferit dhe regjistrimi i automjeteve, pronësia, mirëqenia, statistikat jetike (lindja, divorcet e të tjera të ngjashme).

Edhe shërbimet publike mbajnë disa informacione personale rreth klientëve të tyre dhe pronave përkatëse, duke përfshirë informacionet mbi mënyrën e pagesës së secilit klient për shërbimet e tyre.

Edhe pse bankat ngurrojnë të lëshojnë informacione për klientët pa urdhër gjykatë, të dhënat bankare ia vlejnë që t'u hysh përpjekjeve, pasi ato mund të zbulojnë shumë gjëra dhe, në shumë raste, mund të përdoren si dëshmi për të vërtetuar shkeljet.

Të dhënat telefonike të një subjekti shpesh janë të vlefshme për hetuesit: “Dëshmi të shkëlqyera mund të zhvillohen nga të dhënat e tilla në dritën e faktit se disa njerëz kanë tendencë të jenë të pakujdesshëm në lidhje me përdorimin e telefonit. Edhe një terrorist shumë i sofistikuar herë pas here mund të rrëshqasë dhe të bëjë një telefonatë të pamenduar...”.

Një burim tjetër i dobishëm informacioni janë të dhënat e punësimit. Disa punëdhënës kërkojnë që punonjësit potencialë të paraqesin aplikime të gjata që përmbajnë gjithçka, nga të dhënat e punës që kanë bërë për punëdhënës të mëparshëm, të dhënat për arrestime të mëparshme, të dhëna për arsimin dhe historikun e familjes. Disa kompani i vënë direkt të dhënat në dispozicion, ndërsa të tjerat kërkojnë urdhër gjykatë, veçanërisht për shkak se shumica e agjencive të zbatimit të ligjit nuk mund të zbulojnë arsyen për të cilin e kërkojnë informacionin. Në këtë drejtim, kujdes i veçantë duhet të tregohet kur kontaktoni punëdhënësit në rastet e terrorizmit, sepse “nëse punëdhënësi beson se punonjësi mund të jetë terrorist, ai mund ta pushojë ose ta transferojë atë nga frika”, gjë që mund të sinjalizojë subjektin se është nën hetim. Për këtë arsye, hetuesi nuk duhet të përdorë “terma kompromentues si 'terrorizmi' kur interviston një punëdhënës përveçse nëse ai vërtet beson se natyra e

kërcënimit të paraqitur nga punonjësi kërkon një njoftim të tillë”.



**Kontrolloni të dhënat e gjykatës.** Gjykatat zakonisht mbajnë shënime shumë të sakta dhe për këtë arsye janë burime të shkëlqyera informacioni. Hetuesit duhet të kontrollojnë të dhënat e gjykatës për të mësuar nëse subjekti ka qenë i përfshirë në ndonjë procedurë në atë gjykatë.

**Kontrolloni internetin.** Hetuesit duhet të bëjnë kërkime për emrat e subjekteve të reja nëpërmjet motorëve të kërkimit në Internet për të parë nëse ka ndonjë informacion. Kjo duhet të bëhet veçanërisht në hetimet e terrorizmit, sepse ekstremistët politikë ose fetarë shpesh përdorin internetin për të shpallur kauzat e tyre. Sidoqoftë, hetuesit duhet të kenë parasysh se interneti nuk është domosdoshmërisht burim i besueshëm dhe i saktë dhe të jenë shumë të kujdesshëm në përdorimin e informacionit të internetit si bazë për kontrolle apo urdhra arresti. Gjithashtu, nëse informacioni i marrë nga Interneti çon në ndryshime të rrjedhës së një hetimi, ose e bën një hetues të ndërmarrë një veprim specifik, është e rëndësishme që ky informacion të dokumentohet dhe të pasqyrohet siç duhet në dosjen e çështjes.

**Kontrollet e të dhënave duhet të jenë të plota.** Kontrollet gjithëpërfshirëse të të dhënave janë shumë të rëndësishme në hetimet e terrorizmit. Kontrollet e të dhënave nuk duhet të kufizohen në fillimet e një hetimi dhe hetuesit duhet herë pas here të rishikojnë emrin e subjektit përkundrejt të dhënave në dispozicion, veçanërisht nëse hetimi zgjat gjatë.

**Burimi:** William E. Dyson, *Terrorizmi: Udbëzuesi i një hetuesi*, Botimi i tretë, Anderson Publishing (2008)

## Këshilla praktike

### Teknikat e hetimit të terrorizmit: Survejimi, Pjesa I

“Survejimi” nënkupton vëzhgimin vizual të personave dhe vendndodhjeve të synuara nga ana e organeve të zbatimit të ligjit me qëllim mbledhjen e informacioneve që mund të çojnë në fund në ndjekje penale. Survejimi është një mjet i vlefshëm hetimor, sepse përfshin vëzhgimet faktike dhe në kohë reale të targeteve nga personeli i zbatimit të ligjit, të cilët, si profesionistë, janë dëshmitarë të besueshëm në procedimet gjyqësore. Megjithatë, survejimi ka edhe disa disavantazhe. Së pari, merr kohë, kërkon shumë njerëz dhe kushton sa u përket taksave që duhen paguar për stafin e përfshirë. Së dyti, nuk ka asnjë garanci se do të



prodhojë rezultate pozitive. Së fundi, mund të jetë një teknikë e rrezikshme për t'u përdorur, veçanërisht në hetimet e terrorizmit ku përfshihen subjekte që i kushtojnë shumë vëmendje sigurisë dhe praktikës së masave kundër survejimit. Për të gjitha këto arsye, “gjithë sa më sipër duhen menduar me kujdes para se të përdoret kjo teknikë, veçanërisht në situatat ku teknika të tjera hetimore japin informacione të vlefshme”.

Në këtë numër flasim për llojet e survejimit dhe metodat e ndryshme se si kryhet ai. Në numrin e ardhshëm, do t'ju ofrojmë disa këshilla për përdorimin efektiv të kësaj teknike hetimore në rastet e terrorizmit.

Ekzistojnë tri lloje kryesore survejimi - survejimi në lëvizje, survejimi fiks, dhe survejimi i kombinuar.

Lloji më i njohur i survejimit është **survejimi në lëvizje**, ku oficerët e zbatimit të ligjit e ndjekin subjektin këmba-këmbës, kudo që të shkojë. Edhe pse ndoshta më e thjeshta për t'u organizuar dhe koordinuar, kjo metodë është edhe më e lehtë për t'u diktuar nga vetë subjekti.

Në rastin e **survejimit fiks**, është vetëm subjekti që lëviz, ndërsa hetuesit qëndrojnë në vende fikse përgjatë rrugës së parashikuar të subjektit. Hetuesit në fakt nuk e ndjekin subjektin por e vëzhgojnë dhe vërejnë aktivitetet e tij ndërkohë që ai kalon nëpër stacionet e tyre të caktuara. Pika e fortë kryesore e këtij survejimi është se ka më pak gjasa të zbulohet. Megjithatë, survejimi fiks është shumë kompleks dhe kërkon shumë njerëz, prandaj është më i përshtatshëm për mbulimin e zonave të kufizuara ose për distanca të shkurtra.

**Survejimi i kombinuar** është një përzierje e monitorimit në lëvizje dhe atij fiks. Shumica e ekipeve të konsoliduara të survejimit e përdorin shumë këtë metodë, sepse shfrytëzojnë pikat e forta të këtyre dy llojeve survejimi, duke kufizuar disa nga disavantazhet e tyre: “Metoda e kombinimit kërkon më shumë njerëz sesa një survejim i vetëm; megjithatë, është më e thjeshtë për t'u përdorur sesa metoda fikse, dhe as që i afrohet numrit të njerëzve që kërkon survejimi në lëvizje”.



Ka metoda të ndryshme për kryerjen e survejimit që mund të aplikohen brenda këtyre tri llojeve të përgjithshme survejimi:

**Mbulimi pa pushim.** Kjo metodë përfshin mbulimin e subjektit 24 orë në ditë. Avantazhi kryesor i kësaj metode është se ajo mundëson vëzhgimin e vazhdueshëm të subjektit. Megjithatë, kërkon shumë kohë dhe jep më pak siguri.

**Mbulimi për orare të kufizuara.** Koncepti i kësaj metode survejimi është që subjekti të survejohet gjatë orëve të tij më aktive, kur organet e zbatimit të ligjit mendojnë se ai mund të angazhohet në veprimtari kriminale. Disavantazhi kryesor i kësaj metode është se ekziston një shans që subjekti të kryejë krim gjatë kohës që nuk është duke u survejuar.

**Mbulimi specifik.** Në këtë metodë, subjekti mbulohet vetëm gjatë periudhave kur besohet se do të angazhohet në veprimtari kriminale. Natyrisht, kjo metodë survejimi varet shumë nga inteligjenca e mbledhur përmes teknikave të tjera hetimore.

**Mbulimi kapsulë.** Ideja e kësaj metode survejimi është krijimi i një profili të plotë të subjektit duke përdorur sa më pak burime. Mbulimi kapsulë përfshin mbulimin e një subjekti gjatë një pjese të një periudhe 24-orëshe në çdo ditë të javës. Kjo metodë ka disa variante. Ajo që bazohet në ditët e javës përfshin kryerjen e survejimit, për shembull, për 24 orë çdo të hënë për një muaj rresht. Pastaj, nëse nuk ndodh asgjë, survejimi mund të organizohet gjatë ditëve të tjera të javës gjatë muajve të ardhshëm. Një variant tjetër i kësaj metode e ndan secilën ditë në segmente që mbulohen rregullisht. Për shembull, një subjekt survejohet nga ora 6:00 deri në orën 12:00 të mesditës për një javë. Nëse nuk ndodh asgjë e rëndësishme, javën tjetër mund të mbulohet një segment kapsulë nga ora 12:00 e mesditës deri në orën 6:00 të pasdites.

**Mbulimi i eventeve.** Kjo metodë është projektuar për të mbuluar një person ose një vendndodhje në lidhje me një ngjarje të caktuar. Kjo metodë përdoret më shumë në hetimet e terrorizmit sesa në raste të tjera. Kur përdoret në kontekstin e parandalimit

të terrorizmit, iniciohet survejimi i objektivave logjike rreth datave kur ndodh ngjarja që mbart rrezikun e një sulmi terrorist. Kjo metodë mund të përdoret edhe në përgjigje të një sulmi terrorist, ku mbulimi i individëve të caktuar iniciohet menjëherë pas një sulmi me shpresën se mund të vëzhgohen persona që angazhohen në sjellje të dyshimta.

**Mbulimi i pikave të caktuara (*spot check*).** Një metodë tjetër survejimi që përdoret shpesh nga agjencitë e zbatimit të ligjit është mbulimi i pikave të caktuara. Në këtë metodë, hetuesi kalon në një vend të caktuar për të vëzhguar se çfarë po ndodh atje dhe kush ndodhet atje. Këto kontrole në pika të caktuara bëhen lehtë, me rrezik minimal zbulimi dhe mund të jenë kështu shumë të vlefshme, sidomos në hetimet komplekse. Ato mund të kryhen sistematikisht ose në mënyrë sporadike. Mund të jenë të planifikuara kohë më parë ose pak para se hetuesi të ndodhet në një zonë të caktuar. Sidoqoftë, është thelbësore të merren masa që vëzhgimet e bëra gjatë kontroleve të tilla të dokumentohen siç duhet.

**Burimi:** William E. Dyson, *Terrorizmi: Udhëzuesi i një hetuesi*, Botimi i tretë, Anderson Publishing (2008)

## Këshilla praktike

### Teknikat e hetimit të terrorizmit: Survejimi, Pjesa II

Në numrin e fundit folëm për metoda të ndryshme survejimi, kurse kësaj here ju ofrojmë disa këshilla praktike për kryerjen e survejimit në hetimet terroriste.

Siç është theksuar tashmë, survejimi mund të jetë i vështirë nga shumë aspekte, veçanërisht kur targeti mendohet se është një terrorist. Për këtë arsye, është thelbësore që të shqyrtohen dhe të peshohen me kujdes të gjitha anët pro dhe kundra përpara se të fillojnë operacionet e survejimit. Nëse merret vendim për përdorimin e kësaj teknike hetimore, hetuesit duhet të investojnë në përpjekje për të planifikuar tërësisht mbulimin dhe për ta kufizuar objektin e survejimit sa më shumë që të jetë e mundur, sepse “sa më e gjatë dhe më e gjerë të jetë mbikëqyrja, aq më e madhe është mundësia për t'u diktuar”.

Këtu janë disa praktika të mira për planifikimin dhe ekzekutimin e suksesshëm dhe pa probleme të operacioneve të survejimit.

**Hetimi dhe konteksti i objektivit të mbikëqyrjes.** Oficerët e policisë që do të kryejnë survejimin duhet të informohen tërësisht për objektivin. Atyre duhet t'u jepen fotografi të subjektit, bashkëpunëtorëve të tij të njohur dhe të të afërmeve. Është gjithashtu e rëndësishme që ata të kuptojnë qëllimet e survejimit dhe të njihen me informacionin e mbledhur gjatë hetimit, si dhe me faktet e munguara që duhet të përpiqen të gjejnë nëpërmjet survejimit.

**Automjetet.** Automjetet e përdorura për survejim duhet të jenë të besueshme dhe të mbajtura mirë. Hetuesit duhet të përdorin automjete të zakonshme që përzihen në komunitet dhe që përgjithësisht nuk vihen re. Duhet të shmangët përdorimi i automjeteve që tërheqin vëmendjen, siç janë automjetet e reja, sportive, me porosi, me ngjyra të ndezura dhe automjeteve me dëmtime të dukshme në trup: “Çdo automjet që mund ta bëjë një person mesatar që t'i hedhë edhe një sy tjetër nuk duhet të përdoret në survejim”. Megjithatë, edhe një makinë që nuk bie fare në sy do të diktohej nga objektivi, nëse ky e fundit e sheh shumë shpesh. Për të shmangur zbulimin në operacione të zgjatura survejimi, do të ishte ideale që automjetet të shkëmbeheshin shpesh. Nëse kjo nuk është e mundur, oficerët që kryejnë survejimin mund t'ua ndryshojnë pamjen makinave që ato të duken ndryshe sa herë që i sheh objektivi. Kjo mund të bëhet lehtësisht duke ndryshuar shoferin; duke hequr ose duke ndryshuar disqet e gomave; shpesh duke ndryshuar sendet që varen nga pasqyra e pasme; duke ndryshuar herë pas here gjërat e vendosura në xhamin e pasëm (duke përfshirë lodra pellushi, kapele, veshje, gjëra pa vlerë) ose në kroskot (mbajtëse gotash/filxhanësh, busulla, blloqe shënimesh, façoleta dhe leje parkimi); duke vendosur dhe duke hequr gjëra të ndryshme brenda në makinë, duke përfshirë ndenjësë fëmijësh, karroca fëmijësh, kuti dhe çanta; duke vendosur dhe duke hequr mbajtëse biçikletash (me ose pa biçikleta), zgara bagazhesh mbi makinë apo mbajtëse skish.

**Personeli i survejimit.** Ashtu si me automjetet, është e rëndësishme që oficerët e survejimit të përzihen në vendin ku do të bëhet survejimi. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në survejimet që kryhen në këmbë: “Kur janë në makinë, edhe personat jashtëzakonisht të gjatë, të shkurtër, apo edhe me aftësi të kufizuara duken 'mesatarë'. Megjithatë, në këmbë, kushdo që është i ndryshëm ka gjasa të bjerë në sy”. Oficerët që njihen nga objektivi nuk duhet të marrin pjesë në survejimin e tij. Është e qartë se hetuesit e përfshirë në operacion duhet të jenë të trajnuar si duhet, të kenë njohuri dhe të jenë përgatitur mirë për të trajtuar situata delikate, siç është konfrontimi i mundshëm me objektivin.

**Maskimi.** Hetuesit duhet edhe të përpiqen të ndryshojnë pamje herë pas here, pavarësisht se sa të zakonshëm duken. Mënyra më e thjeshtë për ta bërë këtë është ndryshimi i veshjeve. Pamja mund të modifikohet shpejt nga një pamje formale në pamje sportive, duke hequr njëri prej veshjeve, duke e mbajtur për shembull bluzën apo këmbëzën jashtë dhe jo të futur në pantallona, ose duke përdorur xhaketa, pallto dhe veshje të tjera që mund të vishen nga të dyja anët. Të dobishme për maskim janë edhe kapelet dhe syzet. Të pasurit e disa palëve syzeve optike dhe disa palëve syze dielli me stile të ndryshme dhe një sërë kapelesh prej materialeve të ndryshme është një mënyrë e thjeshtë e ndryshimit të pamjes për një oficer. Një tjetër mënyrë që është veçanërisht e dobishme në survejimet në këmbë, ku oficeri mund edhe të përballlet me objektivin, është përdorimi i disa sendeve që bien shumë në sy (për shembull rripa shumë të mëdhenj, vathë dhe bizhuteri të tjera që bien shumë në sy, fashime shumë të dukshme...) që tërheq vëmendjen nga personi. Ideja është që njerëzit të përqëndrohen tek sendi që bie në sy dhe jo tek fytyra, kështu që nëse ndodh përballja midis oficerit të survejimit dhe objektivit, ky i fundit të mos e njohë më oficerin, nëse ai e heq sendin dallues.



**Teknikat që përdorin terroristët për të diktuar dhe për të shmangur survejimin** Siç është theksuar tashmë, terroristët shpesh praktikojnë masa kundër survejimit. Disa nga gjërat që ata bëjnë për të diktuar dhe për të shmangur survejimin janë:

- *Vëzhgimi konstant i ambienteve* Terroristët përpiqen të jenë të vetëdijshëm për ambientet e tyre dhe njerëzit përreth dhe fillojnë menjëherë të dyshojnë për këdo që mund ta shohin disa herë. Disa terroristë janë të hapur në vëzhgimet e tyre, kurse disa të tjerë përdorin metoda më pak të dukshme, si duke parë mbrapa teksa lidhin këpucët ose duke përdorur sipërfaqet reflektuese si dritaret për të vëzhguar përreth.
- *Drejtimi i makinës në mënyrë të çrregullt.* Terroristët ndonjëherë e drejojnë makinën në mënyrë të pazakontë ose të çrregullt (duke rritur shpejtësinë menjëherë, duke bërë ndalesa të papritura, duke ngarë shumë shpejt ose shumë ngadaltë, duke parkuar rrugës, duke u futur në rrugë qorre) me qëllim që të zbulojnë nëse po i ndjek njeri me makinë.
- *Përdorimi i transportit publik.* Transporti publik mund të përdoret në mënyrë efektive si për të diktuar, ashtu edhe për t'i shpëtuar survejimit: “Një objektiv që papritmas parkon makinën dhe hipën në autobus mund të jetë në gjendje të vëzhgojë nëse dikuh po e ndiqte me makinë. Ai me siguri fillon dhe dyshon nëse sheh dikë tjetër të dalë nga makina dhe të hipë në autobus. Një person në këmbë mund ta përdorë transportin publik edhe për t'i shpëtuar dhe për të diktuar survejimin. Metoda më e thjeshtë është që t'i zbrisni transportin publik një stacion më tej. Kushdo tjetër që bën të njëjtën gjë do të identifikohet si personi që ndjek objektivin.”
- *Përdorimi i bashkëpunëtorëve për të diktuar survejimin.* Terroristët ndonjëherë u kërkojnë bashkëpunëtorëve që t'i vëzhgojnë kur largohen nga një vend i caktuar për të parë nëse po i ndjek dikush.

**Konfrontimi gjatë survejimit.** Duke qenë se terroristët trajnohen për të qenë vigjilent ndaj survejimeve nga forcat e zbatimit të ligjit, mundet që objektivit t'i lindin dyshime për oficerin survejues. Në fakt, konfrontimet mund të vijnë jo vetëm nga objektivit, por edhe nga disa drejtime të ndryshme, duke përfshirë nga bashkëpunëtorët e objektivit, nga një oficer i zbatimit të ligjit që po bën punën e vet, apo qoftë edhe nga persona që nuk janë aspak të përfshirë si një fqinj apo roje sigurie. Reagimi i hetuesit në këto situata është vendimtar, pasi “mënyra se si reagon hetuesi në konfrontime të tilla mund të cojë në suksesin ose dështimin e hetimit”. Për këtë arsye, oficeri i mbikëqyrjes duhet të jetë gjithmonë i gatshëm të japë një shpjegim të besueshëm se pse ndodhet aty ku ndodhet dhe të dalë nga situata pa konfirmuar dyshimin se është duke survejuar dikë.

**Dokumentimi i survejimit** Të gjitha aktivitetet e survejimit duhet të dokumentohen siç duhet, sepse “survejimi është po aq i mirë sa edhe dokumentimi i tij”. Mbajtja e shënimeve është e domosdoshme edhe në rastet kur nuk besohet të ketë asgjë me vlerë apo kur mendohet se nuk është zbuluar asgjë, jo vetëm për shkak se regjistrimet e survejimit një ditë mund të nevojiten për të mbështetur dëshminë e hetuesit në gjykatë, por edhe për shkak se “disa nga informatat në dukje të parëndësishme të zbuluara gjatë survejimit mund të dalin se mund të kenë rëndësi në një fazë të mëvonshme të çështjes”.

**Burimi:** William E. Dyson, *Terrorizmi: Udhëzuesi i një hetuesi*, Botimi i tretë, Anderson Publishing (2008)



## Këshilla praktike

### Teknikat e Hetimit të Terrorizmit: Informatorët, Pjesa I

Në këtë numër fillojmë një diskutim mbi përdorimin e informatorëve. Së pari do të flasim për llojet e ndryshme të informatorëve, kurse në numrin e ardhshëm do t'ju ofrojmë disa këshilla praktike për mënyrën e të vepruarit të informatorëve.

Një informator (i emërtuar ndonjëherë edhe si “burim” nga forcat e zbatimit të ligjit) përkufizohet si “një individ që në mënyrë të fshehtë i siguron informacione të sakta një agjencie të zbatimit të ligjit në mënyrë të vazhdueshme”. Në thelb, ekzistojnë tri lloje informatorësh: informatorë të brendshëm, informatorë periferikë dhe informatorë të jashtëm.

**Informator i brendshëm** është një person që mban një pozicion të caktuar në një grup kriminal ose terrorist, përmes të cilit ai merr dijeni për operacionet e grupit dhe vazhdon të mësojë për aktivitetet e tij. Ai mund të jetë një anëtar aktiv, kontakt i besuar, këshilltar, apo edhe udhëheqës (por jo udhëheqësi kryesor). Megjithatë, informatori ideal nga perspektiva e zbatimit të ligjit, është e vështirë të jetë informator i brendshëm. Këshilla kryesore për krijimin e një informatori të brendshëm është “njohja e armikut”. Kjo do të thotë se një oficer që i afrohet një informatori të brendshëm potencial duhet ta njohë vërtet mirë grupin dhe personin e kontaktuar. Ai duhet të paraqitet me një pamje të pranueshme dhe duhet të jetë në gjendje të iniciojë njëfarë bisede me informatorin potencial. Zyrtari duhet të jetë në gjendje të përcaktojë se si ta tërheqë informatorin që të bëhet burim dhe të përpiqet ta angazhojë, duke i ofruar diçka që atij i intereson. Vendosja e komunikimit me një subjekt terrorist është shpesh detyrë e vështirë, pasi në shumë raste ata mësohen të shmangin kontaktin me forcat e zbatimit të ligjit.

**Informatori periferik** është një person që ka një pozitë më të ulët brenda grupit terrorist dhe që bashkëpunon me disa anëtarë të grupit, si bashkëshort, i afërm, si bashkëpunëtor, ose ka një pozitë jashtë grupit që megjithatë i jep mundësinë të marrë informacione, si fqinj ose si anëtar i një tjetër organizate kriminale. Informatorët periferikë nuk duhet të pritet të japin sasi të konsiderueshme informacioni - ata zakonisht japin informacione mbi pjesë të caktuara të një çështjeje, të cilat ose mund të kenë natyrën e provës ose mund t'i japin hetuesit një pistë se ku mund të marrë informacion. Megjithatë, informatorët periferikë zakonisht janë shumë më të lehtë për t'u gjetur sesa informatorët e brendshëm dhe hetuesit duhet të përpiqen t'i gjejnë ata edhe kur kanë informatorë të brendshëm, sidomos në hetimet që zgjasin shumë.

**Informator i jashtëm** është një person që ka pak ose aspak marrëdhënie me grupin terrorist, por që është i gatshëm të bashkëpunojë me forcat e zbatimit të ligjit duke pranuar të vendoset në një pozitë nga ku mund të marrë informacione të vlefshme për grupin. Ekzistojnë dy lloje informatorësh të jashtëm: informatorë “të vakët” dhe informatorë me një “fillim të ftohtë”. Informator i vakët është një individ që ka dukshëm një marrëdhënie të natyrshme me grupin (për

shembull, nëse grupi është i përfshirë në vjedhje makinash, ky person mund të jetë dënuar pikërisht për vjedhje makinash). Një informator me fillim të ftohtë nuk ka lidhje të qartë me grupin e synuar ose me aktivitetet e tij. Investimi në përpjekje për të rregulluar informatorë me “fillim të ftohtë” ka më shumë kuptim në hetimet afatgjata, pasi futja e personit në grup kërkon shumë kohë. Në këtë drejtim, informatorët me “fillim të ftohtë” praktikisht e fillojnë nga e njëjta pikë si oficerët e infiltruar, pasi “asnjë prej të dyve nuk i ka kredencialet për t'u kualifikuar si anëtar i brendshëm i një grupi”. Për këtë arsye, një agjenci që mendon të ndërmarrë operacione të fshehta kundër një grupi duhet të konsiderojë edhe përdorimin e një informatori me fillim të ftohtë, sepse “mund të jetë një mënyrë e shkëlqyer për të testuar ujërat përpara se të fillojë një projekt i fshehtë, i kushtueshëm dhe intensiv në staf”. Informatorë të jashtëm potencialë mund të gjenden kudo. Ata mund të gjenden mes njerëzve të zakonshëm që në kontaktet e tyre me forcat e zbatimit të ligjit shprehin interes për t'i ndihmuar në punën e tyre. Informatorë potencialë me të ashtuquajturin “fillim të ftohtë” mund të rekrutohen nga informatorë të ngushtë ose të gjenden në hetime të tjera: “Mund të jetë një person periferik në një çështje që dëshiron të bëjë një “marrëveshje” për të shmangur ndjekjen penale, por që nuk ka shumë për të ofruar. Një oficer mund të jetë në gjendje ta përdorë këtë person si informator të këtij lloji, pra informator me fillim të ftohtë në një tjetër hetim penal.”.

Njerëzit bëhen informatorë për arsye të ndryshme. Që të kuptosh se çfarë i motivon informatorët është vendimtare për zhvillimin e suksesshëm të informatorëve: “Zhvilluesit më të mirë të informatorëve janë oficerët që identifikojnë me sukses faktorët që i motivojnë personat që ata synojnë të rekrutojnë dhe që e ndërtojnë gjithë punën mbi atë bazë. Pasi e inkurajojnë personin që të bashkëpunojë, këta hetues e stimulojnë personin duke u mëshuar në vijim këtyre faktorëve motivues”.

**Burimi:** William E. Dyson, *Terrorizmi: Udhëzuesi i një hetuesi*, Botimi i tretë, Anderson Publishing (2008)

## Këshilla praktike

### Teknikat e hetimit të terrorizmit: informatorët, Pjesa II

Në këtë numër, ofrojmë disa këshilla praktike për të punuar me sukses përmes informatorëve.

**Praktikat e menaxhimit të informatorëve** Për çdo informator caktohet një "oficer kontakti". Përveç tij, duhet gjithashtu të caktohet edhe një oficer sekondar ose rezerve që e njuh informatorin dhe që mund të futet e të zëvendësojë oficerin e kontaktit nëse ai nuk është i disponueshëm.

Oficeri i kontaktit duhet të krijojë një dosje kontrolli për secilin informator. Dosja e kontrollit duhet të përmbajë

informacionin personal të informatorit, rezultatet e kontroleve të historikut të tij, kopje të raporteve të tij dhe rezultatet e operacioneve të vetingut që janë bërë për të verifikuar ndershmërinë dhe besueshmërinë e tij.

Informatorët duhet të kuptojnë se “të qenit një informator nuk është një tip karte për të dalë nga burgu falas!”. Oficerët e kontaktit duhet t’ia shpjegojnë informatorit se atij nuk i lejohet që ta shkelë ligjin në asnjë moment kohë - as gjatë mbledhjes së informacioneve për një agjenci të zbatimit të ligjit, as kur është “jashtë detyrës”, - dhe se një arrestim apo ndonjë problem tjetër me ligjin në fakt mund t’u kushtojë pozicionin si informator.

Është thelbësore të sigurohet që informacioni i prodhuar nga informatori të dokumentohet siç duhet sepse, “nga perspektiva e zbatimit të ligjit, nëse informacioni i informatorit nuk është dokumentuar, nuk ekziston”. Zyrtarët duhet të hartojnë raporte përmbledhëse menjëherë pas çdo kontakti me informatorin, për sa kohë e kanë informacionin ende të freskët. Përgatitja e raporteve informuese në kohën e duhur është e rëndësishme jo vetëm për mbajtjen e dosjes së rastit hetimor, por edhe për shkak se ndihmon hetuesin të identifikojë mangësitë e mundshme që duhet të adresohen dhe të kërkojnë menjëherë sqarime ose informacione shtesë.

**Vetingu** Është e rëndësishme që periodikisht të verifikohet saktësia e informacionit të informatorit. Fakti që një informator dikur ka qenë i besueshëm nuk është garanci se do të jetë gjithmonë i besueshëm. Disa nga metodat e verifikimit që hetuesit mund të përdorin janë:

- Rishikimi i informacioneve të mëparshme për të përcaktuar nëse deklaratat më të fundit të informatorit kanë qenë në përputhje me përshkrimet e mëparshme të ngjarjeve;
- Caktimi i një oficeri tjetër për ta udhëzuar informatorin ose sjellja e një oficeri të lartë në seancën e informimit;
- Kryerja e kontroleve të të dhënave me agjenci të tjera për të përcaktuar nëse informatori është angazhuar në aktivitete kriminale për të cilat zyrtari i tij i kontaktit nuk është në dijeni;
- Pyetja e informatorëve të tjerë për këtë informator (Kjo duhet të bëhet natyrisht pa e identifikuar personin si informator);
- Përdorimi i teknikave të tjera hetimore për verifikimin e deklaratave të informatorit;
- Nënshkrimi i raporteve informuese nga informatorët ose nënshtrimi i tyre ndaj testimit të poligrafit (Për disa burime, ideja e nënshkrimit të diçkaje ose një sugjerim i poligrafit do të bëjë që ata të duan të “sqarojnë” disa nga deklaratat e tyre. Megjithatë, këto metoda duhet të përdoren me kujdes pasi disa informatorë mund t’i konsiderojnë kërkesa të tilla si shenjë mosbesimi.)

**Informimi** Informimi i një informatori duhet të kryhet në mënyrë të ngjashme me çdo intervistë zyrtare pune që do të kryente një hetues. Megjithatë, hetuesit ndonjëherë harrojnë të bëjnë pyetje themelore që duhet të zgjidhen gjatë çdo interviste — “kush”, “çfarë”, “kur”, “ku”, “pse” dhe sidomos “si”? Gjithmonë hetuesit duhet të mbajnë mend që ta pyesin

çdo informator se nga e dinë ata se diçka është e vërtetë dhe e saktë. Për t’u siguruar se merrni informacion të plotë dhe të saktë, hetuesit duhet t’i informojnë informatorët sa më shpejt të jetë e mundur pas një ngjarjeje, ndërkohë që i kanë ende të freskëta kujtimet.

**Siguria.** Është e rëndësishme që oficeri i kontaktit të praktikojë teknika të mira të sigurisë në lidhje me takimet dhe komunikimin me informatorin sepse nëse ai e bën këtë, informatori inkurajohet të praktikojë shprehitë e mira të sigurisë. Oficerët e kontaktit duhet të kenë parasysh se informatorët shpesh kanë pak njohuri për atë që përbën siguri të mirë dhe se është në dorën e oficerëve të kontaktit që t’i edukojnë ata.

Informatorët duhet të paralajmërohen që të mos zbulojnë statusin e tyre ndaj askujt tjetër, madje as në situata arrestimi. Shpjegojini oficerit se ata duhet t’i shpjegojnë informatorit se ai nuk duhet të përpiqet t’i shpëtojë një gjobe trafiku, duke zbuluar statusin e tij informator apo t’i shpëtojnë një situatë pa i hyrë gjemb në këmbë për shkak të përmendjes së bashkëpunimit, nëse ai arrestohet për një shkelje më serioze. Sigurohuni që informatori juaj ta kuptojë se kushdo që është në dijeni për statusin e tij informator paraqet një kërcënim për sigurinë e tij dhe se ai nuk duhet t’ia besojë sekretet e tij askujt përveç oficerëve të tij të kontaktit.

Një nga praktikat thelbësore të sigurisë është që të takoheni me informatorët në vende ku nuk ka asnjë person të lidhur me hetimin që mund të vëzhgojë takimin: “Për kontaktet që përdoren si burime, rekomandohet që si vend takimi të përdoren vende të sigurta, duke përfshirë ambiente të sigurta apo dhoma hoteli. Kjo është veçanërisht e vërtetë nëse informatori është me vlerë të madhe, ose nëse duhet të rishikohen dokumente dhe fotografi dhe/ose nëse informimi pritet të jetë i gjatë”.

Nëse oficerët vendosin të përdorin një automjet për takime, ata duhet ta bëjnë këtë me kujdes. Ata nuk duhet ta marrin kurrë burimin me makinë në banesën e tij ose ta shoqërojnë me makinë në zonat ku shkojnë zakonisht subjektet e hetimit.

Zyrtarët nuk duhet ta sjellin kurrë informatorin në zyrat e agjencisë së zbatimit të ligjit në mënyrë të hapur. Nëse një informator duhet të vijë në një objekt të agjencisë së zbatimit të ligjit, sigurohuni që ta organizoni vizitën e tij në mënyrë të tillë që ta shohin pak punonjës, në mos asnjë.

Kuptohet që hetuesit duhet të shmangin veshjet dhe pamjet që mund të tregojnë lidhjen e tyre me policinë kur takohen me informatorin.

**Burimi:** William E. Dyson, *Terrorizmi: Udhëzuesi i një hetuesi*, Botimi i tretë, Anderson Publishing (2008)

# Teknikat e hetimit të terrorizmit: operacionet e infiltuara, Pjesa I

Temat për seksionin e këshillave praktike për këtë numër dhe për numrin e ardhshëm të buletinit do të jenë operacionet e fshehta. Në këtë numër do të përshkruajmë shkurtimisht disa lloje operacionesh të fshehta dhe pika të rëndësishme që agjencitë e zbatimit të ligjit duhet të marrin në konsideratë përpara se ta përdorin këtë teknikë. Në numrin e ardhshëm, do t'ju ofrojmë disa këshilla praktike për kryerjen me sukses të projekteve të fshehta.

Operacionet e fshehta përkufizohen si një teknikë hetimore, ku oficerët e zbatimit të ligjit veprojnë fshehurazi me qëllim zhvillimin e provave për veprimtaritë e paligjshme. Në një operacion të fshehtë, një ose më shumë oficerë të fshehtë vihen në një pozicion që jep mundësi të japin informacion të drejtpërdrejtë rreth veprimtarisë kriminale dhe të dëshmojnë si dëshmitarë të drejtpërdrejtë kundër një subjekti ose një komploti kriminal. Qëllimet e operacioneve të fshehta mund të ndryshojnë ndjeshëm nga një operacion në tjetrin, duke filluar nga një kontakt i thjeshtë i infiltuar, përmes të cilit mblidhen informacione të natyrës së inteligjencës e deri në projekte tejet të sofistikuar që përfshijnë disa hetues njëherësh.

Operacionet e fshehta kanë disa avantazhe. Së pari, ato mund të prodhojnë rezultate spektakolare që nuk mund të përftoheshin nëpërmjet teknikave të tjera të hetimit. Së dyti, ndryshe nga shumica e metodave që përdoren për zgjidhjen e krimeve të kryera, operacionet e fshehta mundësojnë zbatimin e ligjit në mënyrë proaktive dhe duke parandaluar krime që nuk kanë ndodhur akoma. Së treti, për shkak të pozicionit të tyre zyrtar dhe trajnimit, oficerët e zbatimit të ligjit konsiderohen dëshmitarë më të dëshirueshëm në gjykatë sesa informatorët ose qytetarët e zakonshëm bashkëpunues.

Megjithatë, operacionet e fshehta janë në të njëjtën kohë edhe jashtëzakonisht komplekse dhe kërkojnë shumë kohë dhe njerëz, janë të rrezikshme dhe potencialisht të dëmshme psikologjikisht për oficerin e fshehtë dhe për jetën e tij personale.

Ekzistojnë në thelb tre lloje operacionesh të fshehta: operacionet me kontakte të kufizuara, operacione me infiltrim gjysmë të thelluar dhe operacione me infiltrim të thellë.

Në operacionet me **kontakte të kufizuara ose operacionet e fshehta “me një të shtënë”**, një oficer i fshehtë ndërmerr “një ose disa kontakte të shkurtra me një subjekt ose me një person tjetër që ka dijeni për një gjë të caktuar me qëllim mbledhjen e informacioneve ose provave” pa zbuluar identitetin e tij si oficer. Një operacion i tillë mund të përfshijë pjesëmarrjen në një takim, angazhimin e një personi në një bisedë, vizitën në një vend të caktuar etj. Megjithatë ky lloj operacioni i fshehtë zakonisht është afatshkurtër, ai duhet të jetë gjithsesi i planifikuar dhe i dokumentuar mirë.

Në një **operacion me infiltrim gjysmë të thelluar**, oficeri i fshehtë “merr kontakte në një zonë të caktuar me një shkallë të caktuar frekuence, por nuk operon aty gjatë gjithë kohës”. Në këtë lloj projekti, oficeri i fshehtë duhet të ketë mjete cilësore për të mbështetur identitetin e tij të rremë, duke përfshirë dokumentacionin e rremë personal dhe të automjetit, dhe nganjëherë edhe një vendbanim ose punësim të rremë që subjekti mund ta shohë nëse është e nevojshme.

**Operacioni me infiltrim të thelluar** është niveli më kompleks i punës së infiltrimit. Kjo është detyrë me kohë të plotë, ku një oficer i infiltuar bashkohet me subjektin ose konspiracionin e synuar me kohë të plotë. Kjo do të thotë se oficeri i infiltuar thellë nuk duhet të kryejë punë të tjera policore dhe se agjencia e zbatimit të ligjit nuk duhet ta përdorë atë për të kryer njëkohësisht edhe funksione të tjera të fshehta në raste të ndryshme, përveç atyre që kanë të bëjnë me të njëjtin lloj krimi dhe që mund të jenë plotësuese të rastit të synuar.

Siç është theksuar më sipër, operacionet e fshehta janë shumë komplekse dhe “përfshijnë shumë më shumë sesa një hetues që u prezantohet të tjerëve ndryshe nga kush është në të vërtetë”. Për këtë arsye, agjencitë e zbatimit të ligjit duhet të peshojnë tërësisht anët pro dhe kundra përpara se ta përdorin këtë teknikë hetimi, duke marrë parasysh veçanërisht këto pika:

**A janë shteruar të gjitha teknikat e tjera të hetimit?** Nëse të njëjtët objektiva mund të arrihen me teknika më pak kërkuese, atëherë operacionet e fshehta nuk duhet të përdoren.

**A kemi të bëjmë me një situatë emergjente?** Situatat ku mund të vihet në rrezik jeta e njerëzve mund të kërkojnë fillimin e një operacioni të fshehtë. Për shembull, nëse një grup ekstremist po përpiqet të gjejë eksplozivë për të bombarduar një objektiv, një oficer i fshehtë mund të marrë rolin e një ofruesi eksplozivësh, në mënyrë që këtë kërkesë të mos e plotësojë dikush tjetër.

**A ka një person të përshtatshëm dhe të disponueshëm që mund ta marrë përsipër këtë rol të fshehtë?** Operacionet e fshehta janë unike dhe kërkojnë aftësi të caktuara dhe talente që shumë njerëz nuk i kanë dhe madje edhe hetuesit që posedojnë cilësi të tilla mund të mos jenë në gjendje ose mund të mos jenë personat e përshtatshëm për të marrë pjesë në detyra të fshehta për arsye të tjera (për shembull, për shkak të ndikimit negativ që operacione të tilla mund të kenë në jetën e tyre familjare, për shkak se njihen si zyrtarë të zbatimit të ligjit ose për shkak se ata kanë përgjegjësi të tjera të specializuara brenda agjencisë së tyre të zbatimit të ligjit. Në cdo rast, ndoshta është më mirë që të lihet projekti sesa të përdoret një operativ i papërshtatshëm për një rol të fshehtë.



**A mundet agjencia të ruajë sigurinë e plotë të operacionit?** Për operacionin e fshehtë nuk duhet të kenë njohuri në departament dhe as në prokurori. Specifikat e operacionit të fshehtë duhet t'u bëhen të dituara vetëm personave që është e domosdoshme të jenë në dijeni për to.

**A është agjencia në gjendje ta mbrojë oficerin e fshehtë?** Agjencia e zbatimit të ligjit duhet të bëjë një vlerësim të mirë të asaj që kërkohet për ta përmbushur këtë angazhim sepse “sa më i rrezikshëm të jetë objektivi, aq më shumë mbrojtje mund të duhet për hetuesin e fshehtë”. Sigurimi i oficerit të fshehtë mund të kërkojë marrjen e një sërë masash paraprake si mbikëqyrja, mbulimi elektronik, madje edhe caktimi i zyrtarëve shtesë për të funksionuar në role të tjera të fshehta.

**A është agjencia në gjendje të përballet me pasojat?** Nëse rezulton se një agjent i fshehtë dhe familja e tij janë në rrezik, ose në qoftë se kompromentohet funksionimi i mëtejshëm i agjentit të fshehtë si zyrtar i zbatimit të ligjit, agjencia përkatëse e zbatimit të ligjit duhet të jetë e gatshme ta transferojë operativin e fshehtë larg zonës ku është ndërmarrë projekti i fshehtë.

**Burimi:** Eilliam E. Dyson, *Terrorizmi: Udbëzuesi i një hetuesi*, Botimi i tretë, Anderson Publishing (2008)

## Këshilla praktike

### Teknikat e hetimit të terrorizmit: operacionet e infiltuara, Pjesa II

**Përzgjedhja e një oficeri të infiltuar.** Përzgjedhja e një oficeri të përshtatshëm për një rol të infiltuar është një nga faktorët kryesorë për suksesin e operacionit. Këtu janë disa pika që duhet të merren parasysh për të qenë të sigurt se po bëjmë zgjedhjen e duhur.

*Përvoja.* Projektet e infiltuara duhet t'u besohen vetëm hetuesve me përvojë: “Një nga vlerat kryesore të punës së infiltuar është se e vendos hetuesin e kualifikuar në një pozitë ku ai mund të përdorë gjykimin dhe njohuritë e tij të mira për të mbledhur prova të mjaftueshme për ndjekjen penale të të dyshuarit. Nëse kandidati për pozicionin e të infiltuarit nuk i ka këto attribute, një nga arsyt kryesore për përdorimin e teknikës së fshehtë kompromentohet”.

*Përshtatshmëria.* Megjithatë, fakti që një oficer është hetues shumë i mirë nuk do të thotë domosdoshmërisht se ai do të jetë po aq efektiv në punën e infiltuar. Oficeri i infiltuar duhet të posedojë karakteristika që do t'i mundësonin atij të përzihet në situatën e synuar me sa më pak sforcë. Ai duhet të ketë disa aftësi, talente ose cilësi që do të bënin që grupi të donte ta rekrutonte dhe ta pranonte si “pjesë të bandës”. Është e rëndësishme që oficeri të jetë në gjendje të përshtatet me projektin dhe me atë cka kërkon përfshirja në të. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të mbani mend se fakti që ai ka qenë i suksesshëm në një punë të mëparshme të infiltuar nuk është domosdoshmërisht garanci se do të jetë i përshtatshëm edhe për një projekt të ri.

*Maturia dhe Stabiliteti.* Puna e infiltuar mund të jetë shumë kërkuese. Mundet që oficeri të ndihet shumë i vetmuar, të përballet me presion të madh dhe të ekspozohet ndaj shumë tundimeve të padëshiruara. Për këto arsye, është e rëndësishme që operative që infiltrohet të jetë një person i pjekur dhe i qëndrueshëm. Një pikë tjetër që duhet marrë parasysh në këtë drejtim është nëse ekziston rreziku që kandidati i infiltuar të ndërrojë kah dhe të bëhet pjesë e kauzës terroriste. Duhet të shmanget vendosja e një oficeri të infiltuar në një grup me të cilin ai ka pikëpamje të ngjashme politike. Po kështu, as një oficer shumë i dhënë pas besimeve

që janë në kundërshtim me ato të grupit të synuar nuk është një zgjedhje e mirë për atë detyrë të infiltuar.

*Rekorde të pastra personale.* Oficeri i infiltuar duhet të ketë rekorde të pastra si personel. Nëse në historikun e oficerit ka pasur masa disiplinore, këto mund të dëmtojnë besueshmërinë e tij në gjykatë, veçanërisht nëse ai ka qenë objekt masash disiplinore për dhënie deklaratash të rreme, gënjeshtërash, ose për mosndjekje të urdhrave në detyrë.



**Oficeri i kontaktit.** Ajo cka është e domosdoshme është caktimi i një oficeri kontakti në infiltim të thellë dhe disa operacione gjysmë të infiltuara. Roli i oficerit të kontaktit është që të shërbejë si lidhje midis agjencisë së zbatimit të ligjit dhe operacionit të infiltuar. Ai duhet të organizojë, ose në situata të caktuara, të bëjë informimin e oficerit të infiltuar. Ai duhet të transmetojë mesazhet mes oficerit të infiltuar dhe agjencisë. Oficeri i kontaktit duhet të dëgjojë oficerin e infiltuar, ta monitorojë nëse jep shenja dobësimi apo nevojë për ndihmë, si dhe t'i ofrojë këshilla. Funksionet e oficerit të kontaktit përfshijnë edhe kujdesin për një sërë çështjesh personale të oficerit të infiltuar, duke përfshirë pagimin e faturave të tij, marrjen e postës, kujdesin për automjetin e tij dhe për gjëra të tjera në pronësi të oficerit të infiltuar. Oficeri i kontaktit duhet të jetë një oficer i përgatitur i agjencive të zbatimit të ligjit, mundësisht me përvojë në infiltim. Ai duhet të jetë një person i qëndrueshëm, i pjekur dhe empatik, dëgjues i mirë dhe që gëzon respektin dhe besimin e oficerit të infiltuar.

**Sigurimi i dokumenteve të falsifikuara.** Dokumentet e falsifikuara që mbështesin identitetin e ri përbëjnë themelin e "krijimit" të oficerit të infiltruar dhe prandaj duhet të trajtohet shumë seriozisht: "Dokumentet e dobëta mund të shkatërrojnë oficerin e infiltruar njësoj sic mund të rrëzohet një ngrehinë për shkak të themeleve të hedhura keq". Nga cilësia e atyre dokumenteve mund të varet deri edhe jeta e agjentit të infiltruar, prandaj agjencia e zbatimit të ligjit duhet të marrë masat që identiteti i tij i rremë ë jetë aq cilësor sa t'i bëjë ballë kontrolleve. Po kështu, agjencia e zbatimit të ligjit duhet të marrë masat që të mbledhë copëzat që e bëjnë oficerin e infiltruar të duket fiks si ai që pretendon se është. Për shembull, nëse në shtëpinë e oficerit të infiltruar do të vijë për vizitë targetet apo ose kushdo që raporton te targetet, shtëpia duhet të jetë e mobiluar në mënyrë që të mos ketë asnjë dyshim se oficeri i infiltruar jeton atje.

**Kurthi.** Në rastet që ndërtohen mbi bazën e provave të marra nëpërmjet operacioneve të fshehta, të pandehurit shpesh pretendojnë para gjykatës se u është ngritur kurth: "Të pandehurit pretendojnë se ka qenë oficeri i infiltruar ai që në njëfarë mënyre i ka detyruar të shkelin ligjin. Terroristët

pretendojnë se edhe pse mund ta urrejnë qeverinë, ata kurrë nuk do kishin pasur për qëllim të ndërmerrnin asnjë veprim të paligjshëm kundër saj nëse nuk do ua kishte sugjeruar oficeri i infiltruar". Oficeri i infiltruar duhet të ushtrojë kujdes të madh gjatë gjithë rrjedhës së operacionit për t'u siguruar se ai nuk ndërmerr asnjë veprim që mund të përbëjë ngritje kurthi. Për të mbrojtur veten nga pretendimet për ngritje kurthi, oficeri i infiltruar, si dhe oficerë të tjerë të zbatimit të ligjit që ofrojnë mbështetje për operacionin e fshehtë, duhet të dokumentojnë me kujdes veprimet e tyre. Për të shmangur akuzat për *provokim*, oficeri i infiltruar duhet gjithashtu të kujdeset për të mos shfaqur prirje lidhësi apo 'marrjeje përsipër të përgjegjësive', sic janë zakonisht të prirur të bëjnë oficerët e policisë: "Do të jetë shumë e vështirë për të ndjekur penalisht një komplot penal, ku oficeri i infiltruar mund të jetë sjellë si lider apo si personi që vendos'."

**Burimi:** William E. Dyson, *Terrorizmi: Udhëzuesi i një hetuesi*, Botimi i tretë, Anderson Publishing (2008)

## Këshilla praktike

### Teknikat e Hetimit të Terrorizmit: Skena e krimit

Edhe pse hetimi që rezulton në parandalimin e një krimi është gjithmonë hetimi që preferohet krahasuar me hetimin që nis pas kryerjes së një veprë penale, realiteti është se hetimi penal shpesh fillon pikërisht pasi është kryer krimi. Skena e krimit si vend ku ka ndodhur një akt i paligjshëm mund të jetë jashtëzakonisht e rëndësishme për zgjidhjen e krimit, veçanërisht në rastet e terrorizmit, ku disa nga provat më të vlefshme ka gjasa të vijnë nga vendi ku ka ndodhur sulmi terrorist. Gjithashtu, provat fizike të marra nga vendi ku ka ndodhur krimi janë zakonisht të forta dhe të vështira për t'u kundërshtuar nga një subjekt në gjykatë. Në këtë numër ju ofrojmë këshilla të dobishme për hetimin e një skene krimi.

Pas mbërritjes në vendngjarje, hetuesi duhet së pari të përcaktojë se çfarë ka ndodhur dhe nëse ka ndodhur apo jo një krim: nëse ka pasur një shpërthim, nuk do të thotë domosdoshmërisht se ka shpërthyer një bombë, ashtu sikurse jo çdo zjarr nënkupton zjarrvënie të qëllimshme. Në çdo rast, prioritet kryesor për zbatimin e ligjit duhet të jetë dhënia e ndihmës njerëzve që kanë nevojë për vëmendje të menjëhershme. Pasi të jenë ndihmuar ata që kanë nevojë për ndihmë dhe pasi të jetë përcaktuar nëse ka ndodhur apo jo vërtet një krim, hapat e ardhshëm duhet të jenë identifikimi dhe kapja e autorëve, këqyrja e skenës së krimit dhe marrja në pyetje e dëshmitarëve dhe viktimave të krimit.

Oficerët e zbatimit të ligjit duhet të kenë parasysh se vendi i krimit është më shumë sesa vendi ku ka ndodhur krimi dhe se mund të përfshijë edhe zonat që ndodhen ngjitur me të, mbi të dhe nën të, si dhe gjithçka që ka kaluar nëpër zonë. Vendi ku ka ndodhur krimi dhe vlera e saj për hetimin e përgjithshëm do të ndryshojnë shumë në varësi të natyrës së veprës penale. Vendngjarjet e sulmeve terroriste zakonisht kërkojnë hetime të plota dhe mund të japin prova të jashtëzakonshme nëse kryhen siç duhet. Në këtë drejtim, oficerët që hetojnë vendngjarjet e bombardimeve terroriste, zjarrvënieve dhe incidenteve të tjera të ngjashme të dhunshme nuk duhet të supozojnë kurrë se nuk mund të gjendet asgjë me vlerë në rrënoja, sepse nën rrënoja, ku gjithçka duket se është shkatërruar, mund të gjenden prova të jashtëzakonshme.

Hetuesit duhet të përpiqen ta ruajnë vendngjarjen dhe ta mbrojnë atë nga kontaminimi sa më mirë që provat të rikuperohen në mënyrë të tillë që të mund të pranohen në gjykatë. Megjithatë, sulmet terroriste shpesh gjenerojnë situata që kërkojnë një farë depërtimi në vendngjarje nga palë që nuk janë anëtarë të ekipit të rikuperimit të provave. Këto situata mund të përfshijnë, për shembull, shpëtimin dhe dhënien e ndihmës të plagosurve, trajtimin e rreziqeve të menjëhershme (zjarret, strukturat e pasigurta, toksinat, rrjedhjet e gazit...), kërkimin për pajisje të tjera shpërthyes etj. Edhe pse aksesit në vendin e krimit mund të mos kufizohet plotësisht, zyrtarët e zbatimit të ligjit duhet të marrin masa që në të të lejohen të hyjnë vetëm personat e autorizuar.

Hetimi i vendngjarjes së një krimi duhet të fillojë sa më shpejt që të jetë e arsyeshme, e sigurt dhe e realizueshme: “Mbledhja në kohë e provave është e rëndësishme, por duhet të trajtohet në mënyrë të arsyeshme dhe duke marrë parasysh edhe shqetësimet në lidhje me sigurinë.” Vonesat e panevojshme duhet të shmangen, sepse vonesa në hetimin e vendngjarjes mund edhe të rrezikojnë kontaminimin dhe prishjen e provave: “Gjërat mund të ndryshojnë me kalimin e kohës. Mund të fryjë erë, për shembull, duke bërë që të ikin provat ose që në vendngjarja të kontaminohet me gjëra që mund të sjellë era. Shiu i rëndë mund të zbehë gjurmët e këmbëve. Sende 'të lagura', si ato të spërkatura me gjak, mund të thahen.”



Për t'u siguruar që provat mblidhen në mënyrë të organizuar, hetimi i vendngjarjes duhet të planifikohet mirë dhe të koordinohet para se hetuesit të futen në zonë. Kur futen në vendin ku ka ndodhur krimi, ata duhet të dinë saktësisht se çfarë duhet të bëjnë. E mira është që vendngjarja të ndahet në disa seksione para se të nisë hetimi. Secilit hetues duhet t'i caktohet një seksion specifik dhe detyra specifike që duhet të kryhen brenda asaj zone. Kuptohet që qëllimi i kryerjes së një hetimi të mirëplanifikuar të skenës së krimit mund të bjerë ndesh me reagimin shpejt ndaj një sulmi terrorist. Agjencitë e zbatimit të ligjit mund ta zgjidhin një pjesë të kësaj përplasjeje, duke u përgatitur paraprakisht, duke krijuar plane për t'u përgjigjur llojeve të ndryshme të incidenteve terroriste dhe duke i praktikuar ato plane reagimi bashkë me agjencitë e tjera përgjegjëse për reagimin ndaj emergjencave.

Pas mbërritjes fillestare në vendngjarje, zyrtarët e zbatimit të ligjit duhet të intervistojnë dëshmitarët sa më shpejt që të jetë e mundur dhe të përpiqen të përcaktojnë se çfarë ka ndodhur e të mësojnë për autorët e mundshëm, viktimat dhe madje edhe për të tjerë dëshmitarë që mund të jenë larguar nga vendngjarja. Këto intervista fillestare nuk duhet të jenë të thelluara, por zyrtarët duhet të mos harrojnë të marrin informacionet e nevojshme për njerëzit që intervistojnë në mënyrë që ata të mund të lokalizohen lehtësisht për një intervistë të dytë. Edhe nëse dëshmitarët mund të intervistohen plotësisht në vendin e ngjarjes, prapëseprapë mund të jetë e dobishme të flitet sërish me ta në një datë të mëvonshme, sepse mundet që, pasi të ketë kaluar gjendja fillestare e shokut, disa nga këta persona mund të jenë në gjendje të kujtojnë diçka që nuk e kishin përmendur më parë. Hetuesit duhet të bëjnë përpjekje që të paktën të identifikojnë të gjithë ata që mund të kenë qenë dëshmitarë të krimit ose që mund të jenë ndodhur në afërsi të vendit ku ka ndodhur krimi. Punonjësit e operacioneve të shpëtimit dhe personeli tjetër i urgjencës që janë të parët që gjenden në vendngjarje nuk duhet të anashkalojnë si dëshmitarë të mundshëm sepse, edhe pse arrijnë pasi incidenti ka ndodhur, mund të kenë qenë arritur aq shpejt sa që të kenë vërejtur diçka të rëndësishme, siç është largimi i autorit të krimit. Pronari, qiramarrësi ose menaxheri i ambientit ku ka ndodhur krimi duhet gjithashtu të intervistohet sa më shpejt që të jetë e mundur edhe nëse ata nuk e kanë dëshmuar në fakt krimin, sepse duhet parë edhe nëse ata janë kërcënuar dhe nëse janë në dijeni të dikujt që do kishte gjasa t'u sulmonte objektin.

Hetuesit duhet të lokalizojnë çdo kamera sigurie brenda zonës së vendngjarjes dhe të gjitha kamerat që mund të vëzhgojnë njerëzit që hyjnë ose që dalin nga vendi i krimit. E gjithë zona duhet të mbulohet shpejt, sepse në shumë raste regjistrimet e kamerave të sigurisë fshihen automatikisht një herë në disa ditë. Gjithashtu duhet të bëhen përpjekje për të identifikuar njerëzit që mund të kenë bërë fotografi në vendngjarje rreth momentit të incidentit sepse regjistrimet e tyre mund të jenë po aq të vlefshme sa ato të marra nga kamerat fikse të sigurisë.

**Burimi:** William E. Dyson, *Terrorizmi: Udhëzuesi i një hetuesi*, Botimi i tretë, Anderson Publishing (2008)